



MINISTRIA E PUNES, ÇESHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TE BARABARTA
DREJTORIA E POLITIKAVE TE SHANSEVE TE BARABARTA

GRUAJA SHQIPTARE
**GRUAJA SHQIPTARE
DHE
PROBLEMI I BARAZISE GJINORE**

Studim mbi bazë të një anketimi kombëtar

MBESHTETUR: 

Ky botim u realizua nën drejtimin e :

Znj. Marieta Zaçe

Zëvendësministre e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

Stafi i Drejtorisë së Shanseve të Barabarta

Znj. Rajna Kovaçi – Drejtore e projektit

Znj. Valbona Jaupllari – Specialiste

Znj. Irena Benussi – Specialiste

Znj. Brunilda Dervishaj – Specialiste

Rrjeti i pikave të kontaktit për çështjet gjinore në nivel prefekturë

Znj. Tatiana Kurtiqi – Tiranë

Znj. Mimoza Hysi – Durrës

Znj. Donika Ristani – Korçë

Znj. Nevila Haznedari – Berat

Znj. Irena Mero – Elbasan

Znj. Hermina Albunesa – Shkodër

Znj. Manushaqe Spahiu - Diber

Z. Bledar Xhoxha – Kukës

Znj. Lindita Pali – Lezhë

Znj. Dorothea Konomi – Vlorë

Znj. Keti Hysi – Fier

Znj. Jolanda Lipe – Gjirokastrë

Përpunimi statistikor

Znj. Liliana Boçi - INSTAT

Përgatitja e raportit

Z. Gëzim Tushe – Sociolog

PERMBAJTJA

KAPITULLI I

QËLLIMI DHE TREGUESIT STATISTIKORË TË ANKETIMIT.

1. Në vend të hyrjes.....fq.3
2. Qëllimi i studimit.....fq.4
3. Metoda e realizimit të anketimit dhe shkalla e vërtetësisë së të dhënave
 - a. Nga pikpamja territoriale.....fq.7
 - b. Nga pikpamja moshore dhe gjinore.....fq.8
 - c. Nga pikëpamja arsimore.....fq.11
 - d. Ndarja midis të anketuarve nga zona rurale dhe urbane.....fq.13

KAPITULLI II

ANALIZA E SITUATES NGA KENDVESHTRIMI GJINOR

- II.A.1 Gruaja dhe vendimmarrja.....fq.15
- II.A. 2 Barazia gjinore dhe partitë politike.....fq.20
- II.B Fuqizimi ekonomik i gruas.....fq.22
- II.C Personaliteti i femrës dhe problemi i ngacmimit seksual në vendin e punës.....fq.23
- III. Të drejtat e gruas, legjislacioni, mekanizmi institucional.....fq.23
- IV. Kujdesi social.....fq.24
- V. Kujdesi shëndetësor.....fq.26
- VI. Arsimi dhe eliminimi i dallimeve gjinore.....fq.28
- VII. Gruaja dhe media.....fq.30

KAPITULLI III

- REKOMANDIME.....fq.32

SHTOJCA

- Pyetsori.....fq.38
- Tabela dhe grafike.....fq.48

QËLLIMI DHE TREGUESIT STATISTIKORË TË ANKETIMIT.

1. Në vend të hyrjes...

Studimi që keni në dorë është një përpjekje e organizuar nga Drejtoria e Politikave të Shanseve të Barabarta në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, për të vlerësuar situatën aktuale në të cilën ndodhet gruaja shqiptare, për të nxitur një proces ndryshimesh si dhe për të ndërtuar një veprim strategjik afatmesëm në të cilin të parashikohen objektiva dhe ndërhyrje në funksion të këtij qëllimi.

Ky studim u mundësua nga UNFPA (Fondi i Kombeve të Bashkuara për , në kuadrin e projektit për hartimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit për Veprim për Barazi Gjinore.

Kjo përpjekje e organizuar u përqendrua kryesisht në aspekte sasiore dhe cilësore që lejojnë dhe mundësojnë një pamje sa më të gjërë të shfaqjes së problemit të barazisë gjinore.

Natyrisht interesimi i gjithë faktorëve dhe aktorëve politikë, socialë dhe gjinorë për këtë çështje ka ardhur gjithnjë në rritje për shkak të ndërgjegjësimit të një pjesë gjithnjë e më të madhe të popullsisë se analiza dhe përmirësimi i treguesve të “barazisë gjinore” nuk është një problem parcial apo “luks social” por një realitet që kap thelbin e interesit të gjysmës së popullsisë dhe që përbën një nga treguesit esencialë të nivelit demokratik të jetës. Në këtë kontekst studimi është një dokument që i paraprin procesit të hartimit të “Strategjisë së Barazisë Gjinore, 2007-2010”, në të cilin do të plotësohet procesi i njohjes dhe vlerësimit të situatës, duke përcaktuar detyra të natyrës politike e sociale për të gjithë faktorët dhe aktorët që kanë role dhe përgjegjësi për nxitjen dhe thellimin e procesit të barazisë gjinore. Në dokumentin e Strategjisë do të analizohen në mënyrë të qartë dhe më të saktë gjendja aktuale të grave dhe burrave në Shqipëri duke dhënë ecurinë afatshkurtër dhe afatmesme të dukurive; duke synuar të identifikohen mundësitë duke përfshirë politikat dhe institucionet në shërbim të barazisë gjinore; do të identifikohen fushat për ndërhyrje dhe do të formulohen rekomandime për politikat, programet dhe masat për zgjidhjen e problemeve dhe përballimin e sfidave; si dhe do të përcaktohet një buxhet i cili do të jetë një mekanizëm në duart e qeverisë shqiptare për arritjen e synimeve dhe objektivave.

Natyrisht, ky problem është kompleks dhe ka në thelbin e vet, pamjen kryesore të të drejtave të njeriut. Çështja e barazisë gjinore është bërë në kohën moderne një problem universal politik, gjinor, sociologjik, etik, material dhe psikologjik. Problemi në pamje të parë duket se është një i vetëm i lidhur me përkatësinë gjinore të gruas, por në të vërtetë ai është një problem i gjerë social, me shumë pamje dhe prerje që duhen vlerësuar në mënyrë integrale. Dukuria e barazisë gjinore dhe lufta për garantimin e saj është bërë tashmë një nga komponentët më të rëndësishëm të politikës dhe shoqërisë civile moderne në nivel global. Çështje të tilla si shëndeti i grave, shkollimi i vajzave, mungesa e të drejtave ligjore dhe politike realisht të barabarta të grave, janë bërë çështje themelore dhe kanë zënë gjithnjë e më shumë vend në axhendën e politikës sonë.

Në konceptin modern bashkëkohor, të paktën që nga Konferenca e Pekinit e vitit 1995, është ngulitur ideja progresive, se është e vështirë të realizohet përparimi ekonomik dhe shoqëror i një vendi në të cilin ka “një përqindje shpërpjestimore”, në të cilën një pjesë e

popullsisë femërore mbetet e varfër, e pashkolluar, e pashëndetshme dhe e paemancipuar.

Koncepti i “barazisë gjinore”, është një koncept i gjërë me bazament filozofik, social, psikologjik dhe material. Nëse nuk konceptohet në mënyrë simpliste, ai kap një spektër shumë të gjerë problemesh të orientuara në të gjithë sferën e jetës së femrës shqiptare, në shtëpi, në punë, në komunitet, si nënë, bashkëshorte, si bijë, motër, punëtore, studente, qytetare, politikane etj.

Sfida e shoqërisë moderne është e hapur. Ajo ka të bëjë me luftën që shoqëria shqiptare duhet të bëjë me veten e saj, me politikën profesioniste, ndikuese dhe vendimmarrëse, për t’i dhënë “respekt dhe dinjitet të ri” grave dhe vajzave, duke i “dhënë në të njëjtën kohë stabilitet familjes”, si institucioni i parë në të cilin kultivohen të gjithë vlerat, duke përfshirë edhe edukatën e sjelljes dhe qëndrimin të barabartë të pjestarëve të familjes pavarësisht nga përkatësia gjinore e pjestarëve të saj. Është e njohur pesha dhe roli i familjes në edukimin e modeleve kulturore tek pjestarët e saj. Në këtë kuptim bazat e edukatës së barazisë gjinore edukohen, kultivohen dhe rriten në gjirin e saj.

Në luftën e tyre për barazi gjinore gratë shqiptare ndeshen me dy pengesa të mëdha, forca ndikuese negative e të cilave nuk është zbutur as në epokën e tashme të demokracisë. Gruaja shqiptare në luftën për barazi gjinore, ka përballë një traditë shekullore të kultivuar, në të cilën roli i saj ka qënë shumë i reduktuar. Ndërkaq në shoqërinë tonë është me tregues relativisht të lartë një mentalitet të fuqishëm maskilist, i cili është jo vetëm “dukuri nacionale” më rrënjë të forta, por dhe një tendencë me rrënjë të forta rajonale, ballkanike.

* * *

Në mënyrë që studimi të realizohet me sukses dhe që konkluzionet e tij të jenë sa më pranë realitetit, është e nevojshme të sigurohet një sasi të madhe informacioni. Në këtë kontekst duke e vlerësuar nga “principe konceptuale”, sasia e informacionit të grumbulluar nga një system korrekt anketimi dhe një sasi e mjaftueshme të anketuarish, (janë përpunuar të dhëna nga rezultatet e përgjigjeve të 1196 personave) mundëson që jo vetëm të bëhet një analizë lineare e problemit të barazisë gjinore në Shqipëri, por dhe të dilet me disa përfundime të rëndësishme orientuese për punën në të ardhmen për të gjithë faktorët dhe aktorët që kanë role dhe përgjegjësi në këtë proces të vështirë. Ndërkaq, në vlerësimin e rezultateve të anketimit dhe në parashtrimin e ideve është mbajtur parasysh që ato të jenë koherente me dokumente të rëndësishëm, ligje nacionale detyruese dhe Konventa ndërkombëtare në të cilat ne jemi palë ose kemi aderuar në to. Në këtë kontekst janë marrë në konsideratë dokumente të tilla si: Legjislacioni shqiptar, i cili është një legjislacion i mirë, analizuar nga këndvështrimi i barazisë gjinore. Në themel të tij qëndrojnë dokumenta të rëndësishme ndërkombëtarë si Karta Universale për të Drejtat e Njeriut dhe Konventa të tjera për të drejtat e njeriut, ndër të cilat, për aspektin që po trajtojmë, më e rëndësishmja është Konventa e OKB-së "Për Eliminimin e Të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Gruas" CEDAW 1978, ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë më 1993 me Ligjin Nr. 7767.

2. Qëllimi i studimit:

Qëllimi i studimit është që të bëhet një vlerësim i situatës së plotësimit të të drejtave politike, kushtetuese e sociale të grave, duke u nisur nga kërkesa imperative politike që në Shqipëri e sanksionon zyrtarisht barazinë ndërmjet burrave e grave, por që në

praktikë shpesh nuk zbatohet. Përmes interpretimit të të dhënave të anketimit, si dhe analizës së situatës konkrete nga burime të tjera të “informacionit alternativ”, do të bëhet një vlerësim i situatës së pabarazive që shfaqen në shumë fusha të jetës social ekonomike të vendit, sidomos në sferën e vlerësimit të nivelit të zbatimit të mekanizmave ligjorë dhe institucionalë që sigurojnë barazinë e gjinive në Shqipëri, të problemeve të balancës gjinore në vendimarrje, të përpjekjeve që shoqëria, politika por dhe vetë gratë po bëjnë dhe që akoma më shumë duhet të bëjnë për fuqizimin ekonomik, i cili përbën një nga bazat kryesore për afrimin real të barazisë gjinore, do të ketë analiza të nivelit të kërkuar të barazisë gjinore në sferën e arsimit dhe eliminimit të dallimeve gjinore në këtë fushë, përmirësimit të situatës së kujdesit social, kujdesit shëndetsor dhe eliminimit të stereotipeve gjinore me natyrë diskriminuese dhe pezhorative në masmedia.

Qeveria shqiptare, por edhe vetë gratë dhe shoqatat e tyre, janë të vendosura për të ndërtuar politika të reja më moderne dhe nxitëse të cilat, duhet të ndikojnë fuqishëm në realizimin e aspiratës së tyre të vjetër për të jetuar në shoqëri me dinjitet dhe në kushte të barabarta. Në këtë kontekst, studimi i ndërmarrë, është një rast që duhet të shërbejë si “instrument” për të parë më mirë dhe vlerësuar më drejt, nivelin e perceptimit social të shoqërisë shqiptare, shkallën e sensibilitetit të opinionit publik për “barazinë gjinore”, si kusht dhe domosdoshmëri për një shoqëri të drejtë, të barabartë dhe funksionuese.

Në studim ky problem është parë në këndvështrime të ndryshme sociale dhe gjinore duke e vlerësuar këtë situatë të perceptuar, jo vetëm në nivelin “makro” të shoqërisë shqiptare në tërësi, por dhe nga “prerje” dhe këndvështrime të veçanta gjinore. “Prerja gjinore” ose perceptimi i këtij realiteti nga pikpamja e përkatësisë gjenetike, ndihmon për të krijuar një tablo më të plotë të vlerësimit që kanë meshkujt dhe femrat për rëndësinë politike dhe sociale që ka në kushtet e shoqërisë moderne realizimi në praktikë dhe hap pas hapi i barazisë gjinore, si kusht për të patur një shoqëri të drejtë, që të ketë në themel të saj një barazi reale midis femrave dhe meshkujve, një barazi gjinore të vërtetë, jo propogandistike por reale.

Zakonisht studimet sociale nuk janë qëllim në vetvete. Ato realizohen në funksion të qëllimeve të caktuara, që kanë të bëjnë me përmirësime politikash apo veprimesh strategjike në një fushë të caktuar. Natyrisht, studimi që po realizohet për të testuar problematikat, opinionin dhe gjykimin e shoqërisë shqiptare në nivele dhe grupe të ndryshme të përfaqësimit të saj, nuk është qëllim në vetvete, as thjesht për “qëllime njohëse” të situatës dhe nivelit aktual të barazisë gjinore si një nga treguesit më sintetik të “barazisë sociale” në shoqërinë tonë.

Studimi për barazinë gjinore është në të vërtetë “paraprirës” i një angazhimi të ri, të institucionalizuar, politik të shtetit dhe organizatave të shumta të grave, të shoqërisë civile, por dhe të vetë grave, për të ndërtuar një strategji të re të domosdoshme për të rritur ritmet e përmirësimit të situatës së gruas në politikë, në vendimarrje, situatën ekonomike, sociale, të përfshirjes dhe të integritetit të saj si e barabartë, e lirë dhe jo e diskriminuar nga paragjykimet e vjetra apo tabutë e reja.

Në këtë kontekst, studimi është një dokument i cili, i nisur nga përmasat e të dhënave të një anketimi kombëtar, sidoqoftë na krijon një tablo më të qartë të nivelit aktual të “barazisë gjinore”, të problemeve që ndeshen dhe të rrugëve dhe formave me të cilat duhet vepruar politikisht, për të zbutur dukurinë negative, të qëndrueshme, rezistente, të trashëguar, të pabarazisë gjinore që ndeshet në shoqërinë shqiptare, e cila me gjithë ndryshimet ende ka një “taban” të fortë maskilist.

Ndërkaq njohja e thellësisë, intensitetit dhe shtrirjes gjeografike të kësaj dukurie sociale, është një tregues që mund të ndihmojë dhe ndikojë për të realizuar një “Plan Kombëtar Veprimi”, në të cilin do të parashikohen hapat që duhen hedhur, detyrat që duhen përmbushur nga të gjithë aktorët politikë, socialë dhe gjinorë, për të realizuar një ndryshim akoma më të madh të standarteve me të cilat duhet të paraqitet shoqëria jonë moderne edhe në këtë fushë.

Natyrisht studimi është i hapur edhe për përdorime dhe qëllime të tjera të natyrës vlerësuese, studimore dhe statistikore, pasi në të ka një material të bollshëm të grumbulluar dhe të përpunuar me kujdes, jo vetëm nga pikëpamja statistikore, por dhe në aspektin e vlerësimit cilësor të saj.

Konkluzionet e studimit, kanë vlerën e një orientimi se ku mund të përqendrohet më shumë puna e subjekteve që kanë përgjegjësi, dhe detyrë të hartojnë politika, programe, strategji dhe veprime konkrete për të ndikuar pozitivisht në procesin e realizimit “hap pas hapi” të një pune të re më intensive, për të përmirësuar treguesit e barazisë gjinore në shoqërinë shqiptare, duke zbuluar natyrën ende të fortë maskiliste të saj. Ai mund të përdoret nga të gjithë institucionet, sidomos nga ato me natyrë gjinore, organizatat politike të grave, nga OJF-të, që kanë detyra role dhe përgjegjësi promovuese të barazisë gjinore, të rritjes së rolit të gruas në jetën sociale, politike dhe në vendimmarrje, etj.

Për të gjithë këto subjekte të interesuara, studimi është një dokument që duhet parë, qoftë edhe si përpjekja më e fundit studimore për të njohur dhe studiuar problemin e barazisë gjinore në Shqipëri. Qëllimi i studimit, është të evidentohen problemet, prirjet dhe intensiteti i tyre social, të evidentohen problemet që kanë të bëjnë me barazinë gjinore, të ndikohet sa të jetë e mundur me politika dhe ndërhyrje sociale të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta, duke përcaktuar pikat dhe detyrat prioritare të zgjidhjes hap pas hapi të problemit. Në këtë kontekst në studim është synuar që të bëhet një “matje sociale” e problemeve që pengojnë arritjen e objektivave të barazisë gjinore, duke mos fshehur asnjë problem gjinor të grave nën “qilimin e politikës”. Studimi tenton të qëndrojë jo larg politikës dhe ndikimeve të saj të rëndësishme në procesin e luftës së grave shqiptare për barazi, por duke ju shmangur çdo tendence të politizimit dhe të trajtimit të “krahësuar” militantesk.

Çështja e barazisë gjinore, është çështje politike në tërësi, por zgjidhja e saj nuk mund të jetë e lidhur vetëm me objektivat politike të një partie kur është në opozitë apo në pushtet. Duke qënë se çështja e barazisë gjinore është çështje që prek të gjithë gratë si gjini, pavarësisht nga përkatësia e tyre politike, apo dhe nga përkatësi të tjera, ajo është “pikë kritike”, permanente për të gjithë politikën tonë kombëtare e parë në tërësi, pavarësisht nga ndarjet e saj të brendshme, me natyrë demokratike. Problemi i “barazisë gjinore” duhet të kthehet në një çështje kryesore për të gjithë politikën shqiptare të të gjithë krahëve, dhe ky objektiv duhet vendosur në prioritetin e axhendave të tyre për ta kthyer “problematikën gjinore” në interesim permanent të politikës, dhe jo trajtim në formë fushatash. Lufta për barazi gjinore është një nga përpjekjet e komunitetit të të gjithë grave shqiptare sot, pavarësisht nga bindjet apo rreshtimi i natyrshëm partiak i tyre. Në studim në asnjë rast nuk është llogaritur as nuk është kërkuar të dihet se cila është bindja politike apo përkatësia partiake e të anketuarve. Kjo sepse është e vërtetuar se ndjeshmëria e grave dhe lufta e tyre për barazi gjinore nuk është e kushtëzuar nga përkatësia e tyre politike. Është gjë pozitive që kjo luftë e grave për tregues më të mirë social-ekonomikë, për barazi gjinore më të plotë, reale dhe të vërtetë, është pothuajse një mendim dhe veprim konsensual i të gjithë grave shqiptare, pavarësisht nga përkatësitë e tyre politike. Madje edhe nga përkatësi të tjera, të cilat nuk ndikojnë në vullnetin e tyre të pakthyeshëm për më shumë barazi.

Në këtë pikë, në këtë proces të madh, të guximshëm, sfidues të luftës së shoqërisë shqiptare për barazi gjinore, për ngritjen dhe afirmimin e personalitetit social të grave, politika shqiptare duhet të jetë unike, e “bashkuar” për të përballuar frontalisht detyrën e madhe që ka të bëjë me thelbin e shoqërisë moderne, të vendosjes së lirisë dhe barazisë për çdo qenie njerëzore pa bërë dallim gjinor, racor, fetar, kulturor, etnik. Në këtë kontekst duhet parë nga politika edhe çështja e barazisë gjinore.

3. Metoda e realizimit të anketimit dhe shkalla e vërtetësisë së të dhënave.

a) Nga pikëpamja territoriale

Studimi është i bazuar në sistemin e “anketimit” përmes pyetësorëve të formatuar në përputhje me qëllimet dhe synimet e studimit. Më qëllim që rezultatet e anketimit të jenë sa më të plota, sa më afër të vërtetës, ai u shtri në 12 Prefektura të vendit, nga zonat më të fuqishme, më të zhvilluara metropolitane, deri tek ato më rurale dhe periferike. Në një farë mënyre, “gjeografia e studimit” është në të gjithë Shqipërinë. Kjo shtrirje nacionale e anketimit, është gjykuar të shërbejë si mundësi për të testuar më gjerë dhe sa më pranë të vërtetës problematikën, psikologjinë, perceptimin social për problematikën gjinore në një shtrirje gjeografike sa më të gjërë të testimit me anë të anketave.

Megjithatë, duke parë shpërndarjen dhe grumbullimin numerik të “fletë-anketave” të plotësuar, dhe rezultatet e përpunuara, duket se ajo nuk ka qënë e barabartë nga pikpamja sasiore. Nëse do të shikojmë me vëmendje studimin nga ky këndshikim sasior i shtrirjes së anketimit, do të vëmë re se shumica e anketave janë realizuar në qytetet kryesore të vendit si Tiranë, Korçë, Elbasan, Vlorë, Fier, Durrës dhe më pak anketime janë realizuar në qytete të tjera si Shkodër, Dibër, Lezhë, etj.

	Prefektura	Numri	%
1	Berati	65	5.4
2	Dibra	54	4.5
3	Durresi	99	8.3
4	Elbasani	90	7.5
5	Fieri	82	6.9
6	Gjirokastra	58	4.8
7	Korca	114	9.5
8	Kukesi	60	5
9	Lezha	59	4.9
10	Shkodra	42	3.5
11	Tirana	389	32.5
12	Vlora	84	7
Total		1196	100

Natyrisht, duket se kjo ndarje në përqindje të diferencuar e fletë-anketave është e kushtëzuar në një masë të konsiderueshme edhe nga sasia e popullsisë që jeton në këto rajone. Është normale që në tërësinë e anketimit të kryer, fjala vjen, Tirana të ketë 32.5% të të anketuarve. Kjo peshë e Tiranës në anketim është e logjikshme dhe ndikuese në vlerësimin e së vërtetës, pasi edhe numri i popullsisë që jeton në këtë qytet është shumë i madh. Kjo “logjikë përpjestimore” ka qënë me sa duket dominuese në ndërtimin e sistemit të shpërndarë të anketimit.

Është fare normale dhe krejt e arësyeshme, që për të gjetur një mesatare të gjyimit apo për të vlerësuar peshën, kahjen, tendencën e psikologjisë sociale të shoqërisë tone, për çështjen e barazisë gjinore dhe të problematikës së gruas në tërësi, të vlerësohet përpjestimi, raporti midis popullsisë efektive dhe numrit të të anketuarve, që ai të jetë sa më afër realitetit si strukturë gjinore, moshore, shpërndarje gjeografike etj. Megjithatë në këtë kënd vështrimi ka dhe “diskordanca sasiore”, midis popullsisë së rajoneve ku është zhvilluar anketimi dhe sasisë së anketave të realizuara. Fjala vjen, sasia e anketave të realizuara në Shkodër është shumë e ulët në raport me popullsinë që jeton në këtë prefekturë. Shifra prej 3.5 përqind e anketimit që është realizuar në këtë qytet, është më e ulta në anketimin që është realizuar në shkallë vendi. Ndërsa ndarja në rajone dhe qytete të tjera të vendit, është bërë e bazuar në logjikën proporcionale të raportit midis numrit të popullsisë dhe madhësisë së “testit anketues”. Kështu që në një farë mënyre, kjo gjeografi e testimit është e formatuar drejt nga pikpamja sasiore dhe të lejon që të mund të analizosh problemet e gruas dhe të barazisë gjinore në nivel kombëtar. Është gjithashtu pozitiv fakti, që për një studim me përmasa të tilla gjinore janë anketuar në mënyrë rastësore 1196 persona nga i gjithë vendi, në të gjithë rajonet e tij. Ky nivel anketimi është i mjaftueshëm për të vlerësuar çështjen e nivelit të problematikës që lidhet me barazinë gjinore në shoqërinë shqiptare sa më pranë realitetit.

b) Nga pikpamja moshore dhe gjinore:

Në mënyrë që studimi të jetë sa më i përafuar me kulturën, gjykimet, paragjykimet dhe mentalitetin e vërtetë social të shoqërisë, anketimi ka një shpërndarje të caktuar moshore. Natyrisht nuk është e mundur që në një sistem anketimi të rastësishëm të sigurohet një shpërndarje e barabartë e anketave për të siguruar një testim të “opinionit moshor” në mënyrë të barabartë.

Në praktikën e sotme moderne të studimeve sociale, është gjithnjë i parashikuar ky “spontanitet moshor”, kjo tolerancë në anketim. Megjithatë edhe në këtë pikpamje, të dhënat e anketimit na tregojnë se studimi është i “balancuar” dhe krijon mundësi për të qënë sa më shumë përfaqësues dhe i përputhur me strukturën dhe përbërjen moshore të shoqërisë shqiptare. Kurba e të dhënave moshore të anketimit, tregon fare qartë një të vërtetë që duhet vlerësuar si e drejtë. Sasia e grupmoshave që kanë marrë pjesë në anketim, është e renditur në përputhje me lidhjen dhe sensibilitetin që ka një “grupmoshë” e caktuar, me problemin e barazisë gjinore. Perceptimet moshore kanë ndikim të natyrshëm në tërësinë e perceptimit social të barazisë gjinore në shoqërinë tonë. Kjo shkallë perceptimi dhe sensibilizimi, ndjeshmëria dhe reagimi ndaj kësaj dukurie nuk është dhe nuk mund të jetë e njëjtë dhe e barabartë në moshë të ndryshme. Është interesant të konstatojmë se moshë e adoleshencës, është më pak e përfaqësuar në treguesit sasiorë të anketimit, në krahasim me grupmoshat e tjera. Këtë realitet e kupton nga fakti që të anketuarit e grup moshës 15-17 vjec zënë vetëm 2.1% të të anketuarve. Ndërsa të anketuarit e grup moshës 18-30 vjec janë të përfaqësuar me 26.8% të të anketuarve, grup moshë 31-40 vjec përfaqësohet me 23.8%. Në pjesmarrësit e anketës duket një interesim më i madh dhe pjesmarrje më e gjërë e grupmoshës nga 41-50 vjec, që është sunduese në anketë nga pikpamja moshore duke zënë gati 31.6% të të anketuarve.

Është me shumë interes studimor dhe praktik, analiza e “kurbës moshore” të të anketuarve për çështjet e barazisë gjinore. Ajo është një kurbë sociale sinusoide, pasi fillon me tregues të ulët të interesimit të njerëzve që jetojnë në periudhën e adoleshencës, rritet së tepërmi në grup moshën e mesme dhe fillon përsëri të ulët në grup moshën e lartë.

	Grupmosha	Numri i pjesmarresve ne anketim	% e pjesmarrjes ne anketim
1	15-17	25	2.1
2	18-30	321	26.8
3	31-40	285	23.8
4	41-50	378	31.6
5	51-60	162	13.5
6	60+	25	2.1
Totali		1196	100

Nuk është rastësi që të dhënat e anketimit, të para dhe të vlerësuara nga pikpamja moshore, shfaqen të ulta për periudhën moshore nga 15-17 vjeç dhe në grup moshën mbi 60 vjeç. Kjo “diagramë moshore” nuk është rastësi, por është e lidhur me raportin dhe statusin moshor të çdo grupmoshe me problemin që ka të bëjë me çështjet e barazisë gjinore. Padyshim, adoleshentët ende nuk e kanë perceptimin e faktit se çdo të thotë që gruaja të jetë e privuar nga barazia sociale, pasi periudha e adoleshencës, tashmë edhe në vendin tonë ka marrë pamjen e plotë të shfaqjes globale, si periudha më e lirë e jetës së njeriut, në të cilën ata janë më të lirë nga mentalitetet e dominimit maskilist të së kaluarës. Jo vetëm kaq por duket se tek adoleshentët po shfaqen shenjat e një qëndrimi të ri shoqëror të barabartë midis mashkullit dhe femrës, ndoshta edhe për shkak të zgjerimit intensive të horizontit kulturor të adoleshentëve, i cili po i thyen shumë “tabu maskiliste” të së kaluarës. Pikërisht këto tabu kanë shërbyer si paradigme sociale në shoqëritë e së kaluarës sonë, për të vendosur që në këtë periudhë moshore të adoleshencës për të vënë “kufijtë e lirisë” së kufizuar dhe të drejtës më të kufizuar të femrës në raport me mashkullin. Që në këtë moshë fillonte kultivimi i stereotipit kulturor gjinor që më pas bëhej dominant për të gjithë mentalitetin social.

Ndërkaq me interesim të ulët në anketim, duket edhe grupmosha nga 50 vjeç e lart, e cila gjithashtu qëndron në krahun zbritës të “kurbës moshore” të studimit. Kjo grupmoshë e marrë në tërësi, kap vetëm 15.6% të të anketuarve. Natyrisht, kjo ka të bëjë me traditën tonë kombëtare e cila si rregull gruan e kësaj moshe, gruan mbi 50 vjece, pasi ka mbaruar jetën intensive dhe aktive seksuale, fillon ta “tolerojë” më shumë duke i hequr disa “barriera kontrolli”, të cilat janë të ndjeshme për grupmoshën e femrave më të reja shqiptare.

Pjesa më e madhe e grupmoshës që ka marrë pjesë në këtë anketim është ajo midis moshës 18 deri në 50 vjeç. Nuk është rastësi që kjo grupmoshë pa dallim gjinor përbën rreth 82% të të gjithë të anketuarve, ose në vlerë numerike, njerëzit që kanë dhënë përgjigje anketës janë 784 persona. Në të njëjtën kohë që nga 1196 persona të anketuar gjithsej vetëm 25 prej tyre janë të moshës 15-17 vjeç. Në të njëjtin nivel përfaqësimi është edhe grup moshë e të anketuarve mbi 60 vjeç. Mbase rastësisht ka ndodhur por sidoqoftë është shprehje e shkallës së interesimit moshor fakti që sasia e të anketuarve në këto dy grup moshë është e barabartë.

Nga ana tjetër duket se bërthamën e anketimit e përbën grupi social që ndodhet në kurbën moshore nga 18 deri në 50 vjeç. Kjo nuk është rastësi statistikore, por një tregues i përputhjes së domosdoshme të periudhës moshore aktive, me interesimin e detyruar për të patur mendim apo shqetësim social dhe personal për çështje të tilla sensitive moshore sic është barazia gjinore, problemi universal i barazisë midis burrit dhe gruas në shoqëri, familje dhe komunitet. Ky segment moshor është shumë i rëndësishëm në këndshikimin e problemit që po studiojmë, pasi kjo është periudha moshore, në të cilën ndodhin procese të tilla që janë bazike dhe themelore për jetën e

njeriut në përgjithësi dhe të femrës vecanërisht. Në këtë segment kohor normalisht fillojnë të shfaqen perceptime gjinore dhe sociale, krijohen relacione bipolare gjinore dhe seksuale, krijohen lidhje të rëndësishme morale dhe emocionale, në të cilën duken hapur raportet gjinore midis meshkujve dhe femrave. Në këtë periudhë ndodh martesë si lidhja më e qëndrueshme e çiftit, krijohet familja dhe krijohen relacionet gjinore brenda saj.

Në këtë periudhë moshore është bota e konkurrencës sociale, e përshtjes me tregun dhe botën e punës, fillojnë të duken dhe të realizohen raporte gjinore të diferencuara midis njerëzve me përkatësi seksuale të ndryshme me karrierën profesionale, gjetjen e punës, të cilat kanë një rëndësi të veçantë në statusin ekonomik të gruas në familje. Për të gjithë këto arsye, duket se interesimi i grup moshës nga 18 deri në 50 vjeç ka qënë kaq i lartë. Sidoqoftë, kjo epërsi e kësaj moshe në tërësinë e anketimit nuk është dobësi e tij. Përkundrazi kjo përputhje e veçantë, e ngritur e nivelit statistikor moshor të anketimit me atë të interesimit të vërtetë për çështjet e barazisë gjinore, është një gjë pozitive që ndikon për të "lexuar" më mirë dominancën e interesimit dhe të problemeve që shfaqen në raportet burrë - grua apo mashkull - femër përgjithësisht në shoqërinë shqiptare aktualisht.

Nuk mund të mos merret parasysh në një studim me natyrë sociale, sidomos që ka të bëjë me probleme të barazisë gjinore, përkatësia gjinore dhe identiteti seksual i të anketuarve. Ky raport në çdo studim social është një nga treguesit e rëndësishëm, për të siguruar "kampionin social" të duhur dhe të përshtatshëm për testim. Sepse për probleme të tilla me natyrë sociale universale, siç është çështja e raporteve të barabarta gjinore, interesimi është jo vetëm i lartë nga pikpamja sasiore, por dhe nga këndshikimi "bipolar". Megjithatë treguesit e përkatësisë gjinore në këtë anketim shfaqen të shbalancuar. Duket se interesimi i grave për të qënë më aktive në përcaktimin e rezultateve të studimit dhe të vlerësimit të nivelit aktual të barazisë gjinore ka qënë më i lartë sesa tek meshkujt. Kështu që nga 1196 të anketuar janë 444 meshkuj dhe 752 femra. Të shprehur në përqindje duhet thënë se femrat kapin 62.9% të të anketuarve, ndërsa meshkujt vetëm 37.1% të tyre.

E thënë akoma më qartë, në cdo tre të anketuar, dy janë femra dhe një është mashkull.

	Gjinia	Numri	%
1	Mashkull	444	37.1
2	Femer	752	62.9
Total		1196	100

Nuk duhet parë si një raport i thjeshtë statistikor ky raport i përbërjes gjinore të të anketuarve. Prania e ulët e meshkujve në këtë anketim për një problem kaq të madh social, është një nga treguesit e inercisë së mentalitetit ende të fuqishëm maskilist, i cili në shoqërinë tonë ka peshë të madhe, dhe sipas të cilit ky problem i "barazisë gjinore" është jo çështje që ka të bëjë me thelbin e të drejtave të njeriut, por thjesht është "çështje grash".

Ndërkaq, duket se shoqëria jonë është ende maskiliste dhe larg parametrave të vërtetë të një "shoqërie të hapur", civile, të barabartë nga pikpamja gjinore. Treguesi i pjesmarrjes gjinore të ulët të meshkujve në anketimin për studimin e problematikës së barazinë gjinore, nuk është çështje që vjen nga mungesa e sensibilizimit të meshkujve në "çështje studimi" për problemet specifike të grave, por ky është një tjetër tregues i

mentalitetit që tregon se kjo temë nuk është aq shumë e rëndësishme dhe preokupuese për shoqërinë tonë.

Treguesi sasior i anketimit është në të njëjtën kohë një tregues domethënës se problemi i barazisë gjinore në shoqërinë shqiptare, nuk është bërë ende një problem social i përgjithshëm, për të gjithë shoqërinë pa dallim gjinor. Ky tregues është shprehje e faktit se ende problemet gjinore vazhdojnë të trajtohen nga shoqëria gabimisht, në mënyrë të thjeshtëzuar si “probleme gjinor” që lidhen me ca të drejta që i janë mohuar padrejtësisht gruas nga shoqëria, dhe jo si çështje thelbësore e të drejtave të njeriut. Ky konceptim maskilist i çështjes gjinore, do të zbulohet edhe nga studimi hap pas hapi i treguesve sintetikë dhe prerjeve më të holla të kësaj problematike gjatë analizës së të dhënave të anketimit. Por edhe ky tregues statistikor nuk mund të kalojë pa u vlerësuar, si një nga treguesit më formalë që dëshmon në fund të fundit atë deformancë sociale që ekziston në mentalitetin e shoqërisë shqiptare.

Edhe sikur të jetë në këtë nivel konceptimi social i konfunduar i çështjes së “barazisë gjinore”, duke e interpretuar atë jo si çështje sociopolitike për shoqërinë moderne dhe si të drejtë universale të gruas si qenie njerëzore absolutisht e barabartë, por thjesht si problem, si “çështje grash”, dhe jo si problem social që ka lidhje të drejtpërdrejtë me liritë dhe të drejtat e njeriut në tërësi, kjo nuk është pak. Madje, është shumë nëse përputhja e këtij raporti të anketimit nga pikpamja gjinore, të jetë e vërtetë dhe në harmoni me realitetin e shoqërisë tonë.

Në Konferencën e Pekinit në 1995 dhe në fjalën e shkëlqyer, të ish Zonjës së Parë të Sh.B.A-ve, zonjës Hillari Klinton, u ngrit me forcë të veçantë ideja dhe u përcaktua si detyrë prioritare, për politikën, shtetet, shoqërinë civile por dhe për vetë komunitetin e gjerë të grave, kthimi i çështjes së gruas nga “çështje e mbyllur” gjinore, në çështje të madhe sociale për të gjithë shoqërinë, duke definuar tezën mobilizuese se “nuk është më e pranueshme të diskutohet për të drejtat e grave, sikur të ishin të ndara nga të drejtat e njeriut”. Kjo sfidë e madhe e shoqërisë moderne, e ndërtimit të saj në përmasat e një shoqërie të drejtë, të barabartë nga pikpamja gjinore, kërkon që të ndryshohet “aksi” i mentalitetit maskilist të shoqërisë tonë, e cila me sa duket nanuriset në konceptet diskriminuese dhe të marginalizimit social të gruas dhe të interpretimit të problemeve të saj, jo në tërësi në shoqëri, brenda saj, por si probleme të natyrës gjinore që kanë të bëjnë me femrat si përkatësi gjinore “specifike me natyrë të veçantë”.

c) Nga pikpamja arsimore:

Studimi ka vlerësuar si një komponent shumë të rëndësishëm nivelin arsimor dhe kulturor të të anketuarve, duke tentuar të gjejë nivelin e pikëlidhjes midis mentalitetit social ekzistues të shoqërisë për rëndësinë e barazinë dhe lidhjen e saj me nivelin e zhvillimit arsimor dhe kulturor të shoqërisë. Natyrisht, nuk është e mundur që me të dhënat dhe rezultatet e këtij anketimi të jepen konkluzione të “instancës së fundit” për këtë korrelacion me natyrë sociokulturale. Megjithatë, disa të dhëna janë interesante dhe duhen mbajtur në konsideratë për të njohur ndikimin që ka arsimi dhe kultura në perceptimin gjinor dhe vlerësimin social që ka problemi i barazisë gjinore në shtresa të ndryshme të shoqërisë shqiptare, në të cilat ka dallime dhe diskordanca në aspektin e nivelit sociokulturor dhe arsimor të tyre.

	Niveli arsimor	Numri	%
1	i ulët	73	6.1
2	i mesëm profesional	158	13.2
3	i mesëm i përgjithshëm	205	17.1

4	i larte	658	55
5	pasuniversitar	102	8.5
Total		1196	100

Nga analiza e pjesmarrësve në anketë, duket se shkalla e interesimit dhe e sensibilitetit të shoqërisë me problemin gjinor është e lidhur natyrisht edhe me shkallën e emancipimit kulturor të individëve të saj. Nuk është tezë e re se sa më e kulturuar dhe e arsimuar të jetë shoqëria, aq më shumë reflektuese dhe perceptivë bëhet ajo për problemet sociale të femrës dhe çështjet politiko-shoqërore të barazisë gjinore. Kjo tezë është e vjetër dhe e vërtetuar që nga koha e iluminizmit evropian, që në periudhën fillestare të agimit të qytetërimit modern. Dhe me gjithë kufizimin që ka perceptimi i barazisë gjinore në mënyrë të thjeshtëzuar dhe iluministe si problem i lidhur dhe i kushtëzuar vetëm me nivlin arsimor dhe kulturor të shoqërisë në çdo periudhë të zhvillimit historik, askush nuk ka tentuar të mohojë faktin se sidomos në shoqërinë moderne niveli i korrelacionit të nivelit social të barazisë gjinore është i lidhur dhe reflekton shkallën e zhvillimit sociokulturor të saj. Kjo tezë e lidhjes së sensibilitetit social me nivelin kulturor të shoqërisë, është një nga tezat më të rëndësishme të mendimit sociologjik modern.

Në këtë kontekst, analiza e të dhënave tregon se shumica dërrmuese e atyre që janë angazhuar aktivisht në shfaqjen e mendimeve të tyre në këtë anketim janë njerëz që kanë nivele të larta arsimimi dhe shkollimi. Madje ata përbëjnë shumicën e të anketuarve. Është shumë pozitiv për studimin, fakti që rreth 55% ose 658 të anketuar janë me arsim të lartë. Bashkë me të anketuarit që kanë kryer studime pasuniversitare, kjo shifër shkon tek 700 persona, ose 63.5% e të anketuarve. Ndërkaq, në anketim kanë shfaqur gjykimin dhe perceptimin e tyre, për çështjet e “barazisë gjinore” edhe shumë persona me arsim më të ulët. Kështu 6.1% e pjesmarrësve në anketim janë me arsim të ulët, 158 persona ose 13.2% me arsim profesional dhe 205 persona ose 17.1% e të anketuarve janë me arsim të mesëm të përgjithshëm. Kjo kategori që përfaqëson shtresën sociale të shoqërisë me shkollë të mesme, përbën 39.4% të të anketuarve, ose 436 njerëz të anketuar.

Pra në tërësi, struktura e nivelit arsimor të të anketuarve është e përzier. Kjo strukturë e nivelit arsimor i përshtatet përgjithësisht në mënyrë të përafërt “niveleve makro” të arsimimit të shoqërisë shqiptare. Kështu që interpretimi i të dhënave nga ky këndshikim, është favorizues për të bërë analiza sociale të gjera, sa më afër realitetit të shoqërisë shqiptare. Natyrisht, një prani pak më e madhe e të anketuarve me arsim të lartë nuk përbën problem dhe nuk ka impakte deformuese në studim, pasi edhe kjo shifër është në përputhje me prirjen aktuale të shoqërisë shqiptare, e cila shfaqet e orientuar drejt niveleve të reja të “arsimimit të përshpejtuar” të shoqërisë, sidomos tani, në kushtet e arsimit të lartë të liberalizuar, i cili padyshim së shpejti do të sjellë një “rikonfigurim” të ri të shoqërisë nga pikpamja e nivelit arsimor të saj.

d) Nga pikpamja e relacionit të të anketuarve me punësimin.

Në vlerësimin e rolit social të gruas dhe të barazisë së saj gjinore me burrin, ka një rëndësi të dorës së parë raporti i saj me “botën e punës”. Niveli i punësimit të gruas, është një nga treguesit socialë më sintetik, më të sigurt, që tregon shkallën, nivelin dhe standartet me të cilat operon një shoqëri në një moment të dhënë.

Natyrisht, në kushtet e shoqërisë moderne demokratike, nuk është e lehtë të përdorësh drejtpërdrejt “nivelin e punësimit” si instrument social për të matur shkallën e “përfshirjes sociale” të gruas në punësim. Kjo sepse ky tregues duhet interpretuar me shumë kujdes,

duke llogaritur faktin themelor që është një nga shprehjet e dukshme të lirisë së individit, se çështja e punësimit nuk është më çështje e drejtpërdrejtë shtetërore, por është ekskluzivisht private, që ka të bëjë me lirinë e njeriut dhe të drejtën e tij për të qënë i punësuar ose jo, i punësuar në sektor publik, privat apo i vetëpunësuar. Punësimi në shoqërinë demokratike është çështje private e individit. Në këtë kontekst duhet parë edhe vlerësuar problemi i analizës së treguesve të punësimit.

	Statusi punesimit	Numri	%
1	punesuar ne shtet	780	65.2
2	punesuar ne privat	128	10.7
3	vetepunesuar	84	7
4	shtepiake/ nxenes	145	12.1
5	pensionist	31	2.6
Total		1168	97.7

Natyrisht anketimi i 1196 personave, nga të cilët rreth 70% janë gra, nuk është sasi e mjaftueshme të dhënash, që të ndihmon për përcaktime të sakta të “raportit gjinor” të punësimit në Shqipëri, por sidoqoftë këto të dhëna të ndihmojnë të krijosh një tablo të përafërt dhe një përfytyrim më të qartë të realitetit të këtij treguesi që ka të bëjë me ndikimin e punësimit në perceptimin social të çështjes së “barazisë gjinore”.

Në të vërtetë duket se shumica e të anketuarve që kanë dhënë përgjigje, janë të punësuar në shtet. Sipas të dhënave rreth 65% e të anketuarve kanë marrëdhënie pune me shtetin. Një pjesë tjetër e të anketuarve rreth 128 persona, ose 10.7% e të anketuarve janë të vetëpunësuar, 84 të vetpunësuar dhe vetëm 145 prej tyre ose 12.1% e të anketuarve janë shtëpiakë, dhe vetëm 31 persona ose 2.6% janë pensionistë. Duket se “kampioni” me të cilin do të punohet për të vlerësuar gjykimin e tyre për “çështjet gjinore” është i përbërë më së shumti nga njerëz që kanë marrëdhënie aktive me botën e punës, pasi rreth 992 persona të anketuar, ose 82.9% e tyre janë të punësuar ose të vetpunësuar, ndërsa 176 persona ose 17.1% e tyre, janë ose të papunë, shtëpiakë, nxënës apo pensionistë. Natyrisht ajo që ka rëndësi në këtë rast, është fakti se automatikisht duke qënë se shumica e të anketuarve janë femra, ose më saktë 70% e tyre, kjo të ndihmon që të mendosh se në thelbin e gjykimeve për problemin që po analizojmë është dominant mendimi specifik i grave, psikologjia dhe shqetësimi i tyre kompleks, gjinor dhe qytetar njëkohësisht. Kjo e ndihmon së tepërmi gjykimin me “aks feminist” të problemit edhe konceptimit modern të barazisë gjinore.

d) Ndarja midis të anketuarve nga zona rurale dhe urbane.

Në çdo studim sociologjik, i kushtohet një rëndësi faktit të realizimit të një ndarjeje të drejtë të përkatësisë gjeografike” dhe administrative të të anketuarve, me qëllim që të dhënat të jenë të mesatarizuara në këndvështrimin e tij dhe vlerësimin e shfaqjeve të ndryshme të kësaj dukurie, në “mentalitetin urban” dhe “rural”. Në këtë kontekst, sidomos për një vlerësim të tillë siç është “barazia gjinore” problemi nuk shfaqet i ndarë. Ajo është një dukuri komplekse që duhet vlerësuar në nivel shoqërie, në nivel kombëtar. Pavarësisht nuancave, prirjes dhe intensitetit me të cilin shfaqen problemet gjinore në qytet dhe në fshat, është e sigurt se çështja nuk është e ndarë nga pikpamja gjeografike. Kjo çështje është politike, sociale dhe gjinore e cila pavarësisht nga nuancat me të cilat shfaqet në qytet dhe në fshat, është problem social për të gjithë shoqërinë, që duhet trajtuar si çështje gjinore kombëtare, si problem për të gjithë gratë e Shqipërisë.

	Zona	Numri	%
1	Qytet	1009	84.4
2	Fshat	187	15.6
Total		1196	100

Në këtë kontekst, të dhënat e anketimit në këndshikimin e shpërndarjes së tyre gjeografike nuk janë shumë të ekuilibruara, dhe kjo është një nga mangësitë që ndikon në interpretimin statistikor të rezultatit. Sepse nga 1196 persona të anketuar gjithsej, nga qyteti janë shumica absolute, ose 84.4% e të anketuarve, ndërsa nga fshati janë shumë pak, 187 persona ose 15.6% e të gjithë të anketuarve. Në të vërtetë kjo nuk është vetëm çështje që lidhet me menaxhimin e sistemit të anketimit nga organizatorët e tij, të cilët megjithatë mund të ishin treguar më të kujdeshëm, për të bërë një riorientim më të mirë të ndarjes së fletë-anketave në fshat dhe në qytet, sipas ndarjes së popullsisë sonë në këto dy përkatësi gjeografike.

Ndoshta duhet parë ca më thellë problemi, pasi ka mundësi që ky shpërpjestim i pjesmarrësve në anketim nga pikpamja e ndarjes gjeografike dhe e raportit midis të anketuarve nga zonat urbane dhe zonat rurale, mund dhe duhet të jetë gjithashtu një tregues që nuk duhet parë thjesht si shpërpjestim statistikor i anketimit. Në të vërtetë me siguri që ky “shpërpjestim statistikor numerik” i përfaqësimin më adekuat të pjesmarrësve në anketim në përputhje me raportin demografik të shoqërisë shqiptare dhe të ndarjes së saj në popullsi urbane dhe rurale, është një dukuri që tregon nivelin e diferencuar të “perceptimit” të vlerës sociale që ka ky problem në raport me problemet e tjera me të cilat ata ndeshen në jetën e tyre të përditëshme. Pozita e gruas, problemet e saj nuk perceptohen në të njëjtin nivel sociokulturor në këto dy terrene të cilat kanë dallime dhe specifika të njohura zhvillimi.

Nëse do ta konsideronim këtë tregues të anketimit si të vërtetë, si tregues të nivelit real të interesimit të banorëve të zonave fshatare, veçanërisht të grave të zonave rurale, ndaj problemit që ka të bëjë me “barazinë gjinore”, kjo do të ishte shumë shqetësuese. Por duke abstraguuar nga fakti statistikor dhe duke e parë në këndshikim social dhe sociologjik, përsëri duhet të themi se është një problem vërtet i madh, shoqëror, fakti që interesimi i diferencuar dhe shkalla e ndryshme e perceptimit “brendagjinor”, për çështjet e tyre, midis grave rurale dhe urbane është i dukshëm. Askush nuk ka dyshim se treguesit e “barazisë gjinore” dhe të shkëlqes së të drejtave të grave në zonat fshatare janë më të përkeqësuar. Në të gjithë rastet duket se konkluzioni i parë i të gjithë studimit, është që për të ndryshuar situatën me një ritëm të ri, për të qënë më adekuatë me kërkesat e kohës, për të plotësuar standartet europiane të barazisë gjinore, duhet që të përqëndrohet më me prioritet puna e të gjithë aktorëve, e shoqërisë civile, shtetit, organizatave jo qeveritare me orientim gjinor, në drejtim të ngritjes së nivelit të vetperceptimit gjinor specifik tek gratë që jetojnë në fshat. Mjafton ky fakt për të thënë se në vendin tonë, ka një “handikap” të dukshëm të orientimit të gabuar të shumicës së OJF-ve në qytetet kryesore dhe shumë pak prej tyre veprojnë në fshat. Ky fakt duhet parë thellë, jo si një çështje “organizative” por duhet parë politikisht, si një veprim abuziv në kurriz të gruas fshatare, e cila është larg informacionit social që e bën atë të njohur me parimet e të drejtave dhe lirive të saj universale, si qenie shoqërore.

Ndërkaq, nuk mund të mohohet se në këtë rezultat të ulët vetperceptimi gjinor të grave rurale, ndikon edhe një orientim disi abuziv i “fondeve gjinore”, shumica e të cilave harxhohen për “trajtime pa fund” të grave në kryeqytet, për çështje “teoriko-filozofike”, të cilat janë shumë larg ose në periferi të nevojave të shumicës së grave, sidomos në fshat.

ANALIZA E SITUATES NGA KENDVESHTRIMI GJINOR

II.A.1 Gruaja dhe vendimmarrja.

Analiza e problemit të gruas në vendimmarrje, ka shumë elemente përbërës që duhen studiuar sipas rastit. Megjithatë duhet theksuar që në fillim që pavarësisht nga realiteti me të cilin shfaqet ky aspekt, është me shumë rëndësi fakti që shoqëria shqiptare është e ndërgjegjshme dhe e pranon se ky problem është në disfavor social ndaj gruas. Në të vërtetë shumica e të anketuarve, ose më saktë rreth 94.5% e të anketuarve janë të mendimit se pjesmarrja e gruas në politikë dhe vendimmarrje, është shumë e ulët.

Është shumë interesant dhe me vlerë për analizën e situatës së barazisë gjinore dhe të problemeve që e bashkëshoqërojnë atë, fakti që në këtë përgjigje ka një barazi të plotë si në gjykimin e meshkujve dhe të femrave të anketuara. Nga 752 femrat dhe 444 meshkujt e anketuar, ka dalë një rezultat i cili është vërtetë domethënës dhe me vlerë sociale, pasi përgjigjia ndaj pyetjes se “nëse është e lartë pjesmarrja e gruas në vendimmarrje”, është e njëjta përgjigje si nga femrat dhe nga meshkujt. Më saktë, 94% e femrave dhe 94% e meshkujve të anketuar i janë përgjigjur me “po” kësaj pyetjeje duke dhënë në këtë rast një “dëshmi pozitive” për perceptimin teoriko-social të meshkujve shqiptarë ndaj këtij problemi. Ky fakt, që edhe meshkujt janë të mendimit se pjesmarrja e gruas në politikë dhe vendimmarrje është e ulët, është një tregues pozitiv që duhet shfrytëzuar në luftën për ndryshimin e mentalitetit që pengon aktivizimin me të gjithë potencialet e saj, të gruas në jetë, në punë, në shoqëri, në politikë dhe vendimmarrje.

Ky tregues i perceptimit të drejtë të realitetit të “barazisë në vendimmarrje” është një tregues esencial i nivelit të emancipimit të shoqërisë shqiptare e cila tashmë, krejt ndryshe nga më parë, ka një shkallë më të lartë ndërgjegjësimi për rolin e gruas në shoqëri dhe në vendimmarrje, si një nga treguesit esencialë të barazisë gjinore dhe të periudhës së modernitetit në të cilën tashmë ka hyrë pa kthim shoqëria shqiptare, e cila është e detyruar të integrohet e barabartë me vlerat e qytetërimit evropian.

Nga ky nivel i përgjithshëm i lartë i perceptimit të shoqërisë, për vlerën që ka barazia gjinore e gruas në shoqëri, duhet të nisemi për të përcaktuar mandej, shkaqet sipas rëndësisë që bëhen pengesë për një pjesmarrje më të gjërë të gruas në politikë dhe vendimmarrje. Në mënyrë të qartë duket se në këtë aspekt, një ndikim negativ të dukshëm ka mentaliteti ende i fuqishëm maskilist i shoqërisë shqiptare, e cila ende e ka të fuqishme “paradigmën antifeministe”, sipas të cilës politika dhe vendimmarrja është çështje burrash, në të cilën gratë duhet të kenë qasje të kufizuar. Natyrisht është i njohur fakti që e kaluara historike dhe politike e shoqërisë tonë, ka qënë e tillë që në shekujt gruan e ka parë si qenie jo të denjë për ambientet publike të jetës shoqërore dhe të politikës, por të “denjë” vetëm për ambientin e shtëpisë.

Politika dhe jeta sociale sipas mentalitetit që ka sunduar në shekuj, ka qënë e huaj për gruan. Prandaj mbi bazën e këtij mentaliteti të vjetër, i cili megjithë ndryshimet për mirë që kanë ndodhur kohët e fundit është ende sundues, vazhdojnë të jenë të ulët treguesit e pjesmarrjes së gruas në politikë dhe vendimmarrje. Korraca e mentalitetit maskilist të politikës dhe jetës sociale të shoqërisë sonë, ka ende fuqi të konsiderueshme për të frenuar realizimin e të drejtës së gruas në vendimmarrje, si qenie politike e barabartë me burrin. Ky mentalitet ndikon në ngushtimin e hapsirës së pjesmarrjes së gruas në këto sfera sociale, të cilat ende janë “domene të pathyeshme” të maskilizmit. Ky mentalitet shpesh ka ndikim të gjërë social dhe bëhet bazë për kultivimin e një “modeli kulturor”

social të deformuar, i cili e pranon si normal statusin ende të marginalizuar të pjesmarrjes së gruas në politikë dhe vendimmarrje.

Natyrisht në kohën e sotme, në këtë realitet të ulët të pjesmarrjes së gruas në politikë ka ndikim jo të ulët fakti, që lufta politike në Shqipëri në këto 15 vjet, ka qenë dhe vazhdon të shfaqet si një luftë e ashpër burrash, në të cilën ka pak hapësirë që të jetë pjesmarrëse gruaja, e cila nga natyra është më e brishtë në krahasim me qëndrimin "luftarak" të burrave. Vetë mënyra si konceptohet, zhvillohet dhe realizohet politika në shoqërinë tonë, mungesa e cilësive qytetëruese të saj, vrazhdësia, brutaliteti, sharjet, ofendimet, bëhen pengesë serioze, për ta konsideruar politikën dhe vendimmarrjen si një "ambient natyror", organik dhe të përshtatshëm, edhe për gratë. Politika në këtë kontekst edhe si përmbajtje por edhe si formë, ka përgjegjësitë e veta për nivelin e ulët të përfaqësimit të gruas, në nivelet më të larta të politikës duke filluar nga Parlamenti, deri tek organet më të ulta të pushtetit vendor. Produkt i këtij realiteti është gjithashtu fakti që tek gratë kjo situatë krijon një ndjenjë mosbesimi tek energjitë e veta, për të qënë e denjë dhe e barabartë me meshkujt edhe në sfera të tilla të konsideruara "monopol" i tyre siç është politika dhe vendimmarrja.

Ndër shkaqet që konsiderohen si pengesë për pjesmarrjen e gruas në politikë dhe vendimmarrje, është dhe mungesa e kohës së lirë të grave për t'u marrë me politikë dhe për të qënë aktive në pjesmarrje dhe vendimmarrje. Natyrisht, në këtë situatë ka një ndikim të ndjeshëm fakti që mentaliteti dominant i konsideron punët e shtëpisë dhe kujdesin për fëmijët, si çështje natyrale dhe obligim specifik vetëm të grave. Në të vërtetë, kjo ndarje jo natyrale dhe perceptim maskilist i detyrave brenda familjes dhe shtëpisë si detyrë dhe përgjegjësi vetëm për gruan, është një nga shkaqet që e mban atë "të izoluar" nga bota politike dhe shoqërore. Duke e konsideruar shtëpinë si ambientin më të natyralizuar dhe të detyrueshëm vetëm për gartë, në shoqërinë tonë ka ende një koncept të ekzagjeruar për gruan si "zonjë brenda familjes".


Kjo ndeshet shpesh në mentalitetin social të shoqërisë sonë, e cila në shumicën e saj e konsideron politikën si "punë të papërshtatshme" për gratë. Nga studimi rezulton se, një nga shkaqet e këtij niveli ende të ulët të pjesmarrjes së gruas në politikë dhe vendimmarrje është edhe niveli i ulët i përfaqësimit dhe anëtarësimit të tyre në partitë politike, të cilat përsëri duhet thënë se janë domene burrash. Niveli i ulët i antarësimit të grave në partitë politike, ka padyshim ndikim negativ dhe determinues për afirmimin e gruas në politikë dhe vendimmarrje, pasi partitë janë qendrat ku bëhen politikat e angazhimit dhe ndarjes së përgjegjësive. Pjesmarrja e ulët e grave në partitë politike është e lidhur gjithashtu edhe me faktin se shpesh ato janë arena të forta lufte midis burrave dhe kjo i "detyron" gratë të qëndrojnë ose mënjanojnë ose larg partive politike. Natyrisht, duke qënë se organizimi dhe ndarja e punëve në familjen shqiptare ende është me natyrë maskiliste, ka bërë që "koha sociale" e gruas ende të jetë tepër e kufizuar dhe e pamjaftueshme, që ajo të jetë aktive në shoqëri.

Koha e lirë është kusht universal për të forcuar komponentin social të qytetërimit në përgjithësi dhe veçanërisht për rritjen e hapësirës së integritit të gruas në shoqëri. Mungesa e kohës, ngarkesa e tepërt në familje dhe mungesa e ndarjes së barabartë të detyrave dhe përgjegjësive brenda familjes, e ka bërë të kufizuar mundësinë dhe pjesmarrjen e barabartë të gruas në politikë dhe në jetën shoqërore.

Pa një lirim të gruas nga kjo ngarkesë që padrejhtësisht ende në shoqërinë shqiptare konsiderohet si detyrë ekskluzive e gruas, e cila duhet të përballojë të gjithë ngarkesat e përditshme rutinore të familjes, nuk është e mundur të pretendohet për zgjerim të shanseve dhe të mundësive të saj për të qënë aktive në shoqëri. Në këtë kontekst, nuk mund të flitet për barazi të vërtetë gjinore në shoqëri në kushtet e "pabarazisë së kohës së lirë", midis burrit dhe gruas. Kjo barazi më së pari duhet të vendoset në familje, e cila është një nga institucionet që ka tregues të shbalancuar të barazisë gjinore. Familja

shqiptare është institucioni i parë i cili kultivon, mban gjallë dhe ushqen mentalitetin e pabarazisë gjinore midis burrit dhe gruas, pasi kushtet dhe mundësitë kohore për kontribut social “ekstra familjar” nuk janë të barabarta.

Ndërkaq, nga studimi rezulton se çështja e nivelit arsimor dhe ndikimi i tij në nivelin aktual të barazisë gjinore në shoqëri, nuk konsiderohet si faktor me rëndësi të veçantë nga të anketuarit. Ky realitet është në të vërtetë një tregues i faktit që “pabarazia arsimore” e dikurshme midis burrit dhe gruas është zbutur. Madje ka tregues që flasin për një rritje më të përshpejtuar të nivelit arsimor të grave në krahasim me burrat. Megjithatë, dihet që ky faktor pozitiv dhe favorizues në “rolin social” dhe barazinë gjinore, nuk i jep efektet menjëherë dhe në mënyrë automatike.



Në të vërtetë ka një ndryshim të pjesëmarrjes së gruas në “jetën profesionale” dhe në “tregun e punës”, në sajë të aftësive të veçanta kulturore e profesionale dhe nivelit tepër kompetitiv arsimor, me të cilin ajo shfaqet në jetën publike. Megjithatë edhe në këtë aspekt, megjithë nivelin e ngritur arsimor gratë janë të destinuara përgjithësisht për të luajtur disa role profesionale me natyrë stereotipike gjinore, “të përshtatshme” për natyrën e tyre, duke qënë sidomos të lidhura me sektorët e shërbimit dhe më pak me sektorët e drejtimit dhe të menaxhimit, në të cilët pjesëmarrja e gruas është ende e ulët. Nuk ka shumë nevojë për tregues të tjerë për të interpretuar më saktë këtë shfaqje të pabarazisë gjinore. Mjafton të shikojmë nivelet e ulta të pjesëmarrjes së gruas në jetën politike, prezencën e saj të pamjaftueshme në organet e larta të politikës aktive, të shtetit, pushtetit vendor etj, për të kuptuar se realiteti i angazhimit të gruas që ka kapacitet dhe nivel arsimor të spikatur intelektual, është në nivele ende të ulta. Këtu nuk është fjala që shoqëria të krijojë “hapësira artificiale” për barazi gjinore, duke favorizuar gruan si të tillë, vetëm pse është grua.

Në të vërtetë problemi nuk shtrohet për ta kthyer nevojën për barazi gjinore në luftë për favorizim gjinor. Por nuk është normale që në shoqërinë tonë të jenë ende kaq të theksuara prirjet me natyrë maskiliste të bazuar në koncepte që ende krijojnë epërsi të pamërituar për meshkujt në organet e larta të politikës, shtetit, Parlamentit duke lënë në

minorancë të pamerituar gratë të cilat kanë kualitete arsimore dhe kulturore të krahasueshme.

Në këtë kontekst shoqërisë shqiptare i duhet të kthejë kokën dhe të vendosë në shoqëri konceptin e meritokracisë të pavarur nga përkatësia gjinore e kandidatëve. Favorizimi i burrave në shumë poste e detyra të rëndësishme vetëm për shkak të përkatësisë gjinore, është një nga shprehjet më elokumente, të dukshme të shfaqjes publike të pabarazisë gjinore, e cila duhet të shqetësojë më shumë politikën, shtetin, shoqërinë dhe natyrisht edhe vetë gratë në rradhë të parë.

Në studimin e përgjigjeve të dhëna nga të anketuarit, të bën përshtypje pozitive fakti që ka afërsi në mentalitetin e meshkujve dhe femrave në renditjen e shkaqeve që ndikojnë në mbajtjen e pabarazisë gjinore në shoqëri. Me nuanca fare të holla, përgjigjet dhe renditja e shkaqeve të pabarazisë gjinore janë të përafërta. Ky tregues është shumë domethënës për të treguar nivelin e zhvillimit dhe shkallën e emancipimit dhe të sensibilitetit gjinor. Ka një nuancë theksimi më të fortë tek ndjeshmëria që kanë vetë gratë për shkaqet që krijojnë pabarazi gjinore. Por duke qënë se kjo nuancë nuk ka ndonjë peshë në dallimin e përgjigjeve të dhëna si nga gratë dhe nga burrat, kjo të krijon idenë se “terreni social” ka pësuar ndryshime pozitive. Po kështu ka ndryshuar dhe mentaliteti mashkullor i cili, duke u afruar me atë femëror, shërben për krijimin e një terreni më të favorshëm ndryshimesh pozitive në të ardhmen.

Kjo situatë, ky mentalitet i afruar social midis femrave dhe meshkujve, duhet shfrytëzuar si mjet që favorizon politika nxitëse dhe përmirësuese në treguesit realë të barazisë gjinore.

Mbi bazën e vlerësimit të treguesve të mentalitetit dhe perceptimit social të shoqërisë, për nevojën e barazisë gjinore janë evidentuar edhe rrugët, mundësitë dhe prioritetet që ndikojnë në rritjen e pjesmarrjes së gruas në politikë dhe vendimmarrje. Edhe pse nga pikpamja sociale mund të duket disi paradoksale, rritja e numrit të anëtareve gra në partitë politike në kushtet e shoqërisë shqiptare konsiderohet si kusht kryesor i përmirësimit të kësaj situate. Në të vërtetë niveli shumë i ulët i angazhimit të gruas në politikën aktive dhe në pjesmarrjen intensive në partitë politike është fakt që ndikon negativisht në realizimin e treguesëve të barazisë gjinore. Natyrisht, kjo përgjigje që e konsideron rritjen e pjesmarrjes dhe përfaqësimit të gruas në partitë politike si rrugë prioritare të rritjes së aksesit për barazi gjinore, është e lidhur me faktin se pjesa që përcakton emërimet në poste të rëndësishme të drejtimit dhe administrimit, buron nga politika. Në këtë kontekst niveli i ulët i përfaqësimit të grave në poste kryesore drejtuese, është i lidhur me faktin që ajo gjëndet shumë pak në strukturat e larta të drejtimit në forumet drejtuese kryesore më të larta të partive politike. Po ashtu, me shumë rëndësi favorizuese dhe mbështetëse konsiderohet edhe mbështetja e luftës për barazi gjinore me programe të veçanta qeverisëse.


Normalisht, konsiderohet me rëndësi roli i shtetit dhe i mekanizmave të tij institucionale për të ndikuar drejtpërdrejt në ndryshimin e situatës së barazisë gjinore, për të krijuar kushte institucionale që kjo barazi të mos mbetet në letër por të jetë efektive. Pavarësisht se kjo detyrë nuk është detyrë dhe ekskluzivitet shtetëror, në sytë e njerëzve tanë, ndoshta edhe për shkak të së kaluarës sonë historike 50 vjeçare të totalitarizmit, ekziston një besim i tepruar i njeriut të thjeshtë, për rolin dhe forcën e shtetit si mjet që mund të sjellë barazi. Natyrisht duke e ridimensionuar këtë koncept duke e sjellë nga një koncept me përmasa të hipertrofizuara në një realitet ndikues me dimension normal, duhet thënë se roli i tij për të patur ndikim pozitiv në ndryshimin e realitetin dhe përmirësimin e gjendjes së barazisë së trajtimit të barabartë dhe pavarësisht të përkatësisë gjinore midis burrave dhe grave, është një realitet që nuk mund të mohohet. Shteti ka mundësi të bëhet aleat i shoqërisë civile, duke e ndihmuar atë në betejën e madhe të qytetërimit, një nga treguesit esencialë të së cilës është

pikërisht ndërtimi i një shoqërie në bazë dhe në themel të së cilës duhet të jetë barazia midis burrave dhe grave. Në analizën e rrugëve të mundshme që ndikojnë në këtë aspekt, studimi evidenton çuditërisht si të fundit për nga rëndësia ndikuese, punën e shoqërisë dhe shtetit për ngritjen e shërbimeve të ndihmës sociale si dhe punën trajnuese dhe kualifikuese me gratë.

Padyshim, kjo mungesë besimi për ndikimin pozitiv të shërbimeve të ndihmës sociale dhe të trajnimeve, është e lidhur me faktin që ato nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë por të tërthortë në procesin e realizimit të barazisë gjinore. Duket se shoqëria shqiptare tani ka filluar t'i largohet përfytyrimit të barazisë gjinore si një problem me natyrë kulturore dhe iluministe. Shoqëria shqiptare tashmë, është bërë më pragmatiste dhe beson në zgjidhje dhe ndërhyrje që kanë impakt të drejtpërdrejtë në realizimin e procesit të barazisë gjinore. Në këtë kontekst ajo mendon se vendosja e disa "kuotave detyruese", zbatimi i të cilave është kusht "*sine qua non*", për të ndryshuar situatën e përfaqësimit më të merituar të gruas në organet e larta të politikës, Qeverisë, Parlamentit dhe Administratës Publike ka ndikim më të drejtpërdrejtë në përmirësimin e angazhimit të grave në politikë, madje edhe më shumë se forca ndikuese e trajnimeve teorike.

Në perceptimin e rrugëve të mundshme të rritjes së pjesmarrjes së gruas në politikë dhe vendimmarrje ka dallim midis perceptimit mashkullor dhe femëror, për rëndësinë e shkaqeve dhe përcaktimit të prioritetit të rrugëve të mundshme të realizimit të tyre. Kështu ndërsa gratë vendosin si rrugë të parë për të ndikuar në barazinë gjinore hartimin dhe zbatimin e programeve qeveritare për mbështetjen e gruas, meshkujt janë të mendimit se prioritare në këtë aspekt, është rritja e pjesmarrjes së grave në forumet drejtuese të partive politike.

Në kuadër të punës për të realizuar tregues më të përmirësuar të barazisë gjinore, meshkujt vlerësojnë me më shumë ndikim futjen e politikave të kuotimit dhe të përmirësimit të kodit zgjedhor, madje ata e vlerësojnë këtë aspekt më shumë se sa e vlerësojnë vetë femrat.



Në një studim tjetër alternativ, realizuar përmes një sondazhi publik janë radhitur disa faktorë që sipas perceptimit të të anketuarve kanë një peshë të veçantë në situatën e gruas dhe raportin e saj me vendimmarrjen. Sipas këtij studimi, situata e ndikimit të faktorëve në nivelin e pjesmarrjes së gruas në vendimmarrje, duke marrë vlerësimin në nivel kombëtar, nxjerr në pah disa faktorë që e disfavorizojnë gruan në këtë proces të

rëndësishëm. Një pjesë e mirë e shqiptarëve ose 62.1% e të anketuarve mendojnë se në këtë situatë ka ndikim “tradita e vlerësimit të gruas” në shoqërinë tradicionaliste shqiptare, ndërkohë që 57.8% konsiderojnë si faktor pengues “nivele të sotëm të zhvillimeve sociale”. Natyrisht, duke e njohur faktin se lidhësit e partive politike janë të dominuar kryesisht nga meshkujt, 52.4% janë të mendimit se situata e pjesmarrjes së gruas në vendimmarrjen politike është e lidhur me natyrën maskiliste të lidhësit politik dhe vullnetin përgjithësisht maskilist të tyre. Padyshim, është një gjë shumë pozitive që reagimi i opinionit për “imazhin publik” të grave të angazhuara në politikë është në favor të tyre. Vetëm 28.2% e të anketuarve mendojnë se figura e grave të zgjedhura deri tani në politikë dhe vendimmarrje ka ndikim negativ. Gjithashtu, studimi nxjerr në pah si një nga shkaqet e gjëndjes së pjesmarrjes së gruas në politikë tendencën e mospërkrahjes sa duhet të grave në fushatat zgjedhore. 47.1% vlerësojnë si faktor negativ aplikimin e kuotave të ulta për gratë.

II.A. 2 Barazia gjinore dhe partitë politike.

Për të kuptuar më saktë realitetin e barazisë gjinore të grave në fushën politike, ndihmon së tepërmi fakti që pyetja nëse ‘janë mbështetur njësoj nga partitë politike si kandidatet gra për deputete dhe kandidatët burra’ ka një përgjigje të thellë mohuese. Nuk është rastësi që nga 1196 persona të anketuar, 926 prej tyre, ose 77.4% e tyre i janë përgjigjur negativisht kësaj pyetjeje, dhe vetëm 257 ose 21.5%, mendojnë se kjo mbështetje politike ka qënë e barabartë si për kandidatet gra dhe burra. Ky nuk është thjesht një rezultat i thjeshtë statistikor, por një realitet i dukshëm, që vërteton thellësinë e diferencimit gjinor në jetën politike midis grave dhe burrave.

Me shumë rëndësi është fakti që këtë përgjigje i kanë dhënë kësaj pyetjeje, në mënyrë çuditërisht krejt të barabartë si gratë edhe burrat. Nga anketimi rezultoi se 94.1% e grave dhe po kaq edhe e burrave, mendojnë se nuk janë mbështetur njësoj nga partitë politike si kandidatet gra dhe burra. Ky fakt si dhe shumë të tjerë, është tregues i dukshëm që flet për karakterin ende të theksuar të politikës sonë, e cila është maskiliste, favorizuese kryesisht për politikanët meshkuj dhe e mbuluar ende fuqishëm nga mentaliteti marginalizues për rolin e barabartë të gruas në politikë. Indirekt, pavarësisht se nuk shprehet hapur është i fuqishëm mentaliteti me shtrirje të gjerë sociale, i cili vazhdon të ushqejë mentalitetin patriarkal, se politika është çështje burrash dhe jo problem për gratë të cilat, nuk janë shumë të përshtatshme për një mision dhe profesion të tillë delikat dhe të vështirë, siç është politika.

Natyrisht, jo pak ndikim në nivele relativisht të ulët të përfaqësimit të gruas në strukturat kryesore të politikës, ka dhe fakti që mënyra se si zhvillohet politika në Shqipëri, intensiteti i konflikteve dhe brutaliteti që shpesh shoqëron shfaqjen publike të saj, e bën akoma më të vështirë dhe më të “papërshtatshëm” politikën për gratë. Ky nivel përfaqësimi dhe pjesmarrjeje i grave në strukturat politike qendrore dhe në organet e pushtetit qendror dhe lokal është veçanërisht i ulët në fshat. Gratë e zonave rurale kanë një pjesmarrje akoma më të ulët në politikë dhe vendimmarrje, sesa gratë e zonave urbane. Duke qënë se mentaliteti konservator antifeminist në zonat rurale është akoma më i fuqishëm, ndikimi i tij negativ është ende zotërues në frenimin e pjesmarrjes së barabartë të gruas në organet drejtuese të partive politike, apo në strukturat drejtuese të pushtetit vendor, në bashkitë e vogla dhe veçanërisht në komuna.

Në këtë realitet, ka ndikimin e vet edhe fakti që në fshat komuniteti gjinor i femrave ka ende një nivel të ulët zhvillimi dhe shoqëria civile, si mbrojtëse e të drejtës legjitime të gruas për të patur barazi gjinore dhe të drejtë pjesmarrjeje në politikë dhe vendimmarrjen politike, ka forcë të zbehtë. Në këtë kontekst rrethanat frenuese që ndikojnë ende janë konceptet sociale maskiliste me rezistencë të fortë politike, sipas të cilës gratë duhet të jenë të mbyllura në “qerthullin” e tri “K”-ve. Ajo duhet të rrotullohet

midis Shtëpisë, fëmijëve dhe Institucioneve fetare. Rreziku i këtij rrethi të “ri” me të cilin shoqëria moderne po përpiqet të rrethojë dhe izolojë gruan nga jeta politike dhe publike, përbën një “grackë sociale” të rrezikshme që e largon gruan nga pjesmarrja aktive në jetën politike dhe publike.

Në këtë pikëpamje, “beteja” për barazi gjinore, është detyrë e veçantë e shoqërisë civile dhe e vetë organizatave politike, shoqërore, intelektuale dhe qytetare të vetë grave, të cilat kanë detyrë të luftojnë për të ndalur zgjerimin e koncepteve dhe të mentaliteteve, që padrejtësisht krijojnë korracë që mban të izoluar gruan nga jeta politike dhe e drejta e saj e barabartë në vendimmarrje.

Studimi është përqëndruar me të drejtë dhe jo pa qëllim, pikërisht në këtë rol dhe mision që kanë vetë organizimet e grave, për të ndikuar fuqishëm në rritjen e rolit aktiv të gruas në politikë dhe vendimmarrje, duke ndikuar si “mjet presioni” qytetar ndaj politikave të partive politike, për t’i dhënë një mbështetje më të madhe angazhimit politik të gruas. Në këtë drejtim pretendimi për një rol më aktiv dhe presion më eksplicit të organizatave politike dhe shoqërore të grave mbi partitë politike, për të zgjeruar aksesin e merituar të pjesmarrjes së tyre në politikë dhe vendimmarrje, është kërkesë e ligjshme dhe detyrë imperative e së ardhmes së shoqërisë tonë për të qënë shoqëri e drejtë, me barazi gjinore dhe qytetare. Gratë janë qytetare dhe pjesmarrja e tyre e lirë dhe e barabartë sipas aftësive personale dhe jo thjesht për shkaqe gjinore në politikë dhe vendimmarrje, është kërkesë imperative e shoqërisë moderne.

Nga studimi rezulton se ka një pretendim më të dukshëm për organizatat politike të grave, si faktor që duhet të ndikojë pozitivisht në rritjen e numrit të grave në politikë, në mbështetjen e fushatave elektorale të tyre gjatë zgjedhjeve për pushtetin legjislativ apo vendor. Ky rol konsiderohet si hap i parë kryesor i organizatave të grave, pasi pa këtë mbështetje fillestare që ndikon në nivelin e pjesmarrjes së tyre në politikë, nuk është e mundur që të sigurohet hapi tjetër i rëndësishëm, që ka të bëjë me pjesmarrjen e tyre në hartimin e programeve të partive politike apo në vendimmarrjen ekzekutive. Duket qartë se që të kemi një rritje të rolit të grave në politikë dhe vendimmarrje, më së pari do të duhet të kemi një rritje të dukshme të numrit të tyre në politikë, një mbështetje elektorale të veçantë, në mënyrë që ato pastaj, të jenë pjesmarrëse aktive në hartimin e programeve të partive politike dhe rrjedhimisht edhe në vendimmarrjen ekzekutive.

Hapi i parë është rritja e pjesmarrjes fizike dhe numerike, e cila është detyrë paraprake dhe kusht kryesor, për të patur pastaj edhe hapat pasues të përfaqësimit të tyre dinjitoz në politikën profesioniste dhe në nivelet e ndryshme të pushtetit ekzekutiv. Në këtë renditje të rëndësishme së hapave për pjesmarrjen e grave në politikë, janë të një mendimi si renditje faktorësh edhe meshkujt edhe femrat e anketuara, pavarësisht nga diferenca e vogël në përqindjen e vlerësimit të çdo faktori. Edhe në këtë pikë duket që ka një sensibilitet social të ekuilibruar dhe një vlerësim të drejtë të faktorëve që ndikojnë në procesin e vendimmarrjes së grave në politikë, sipas rëndësisë së tyre të drejtpërdrejtë në proces.

Vlerësimi konsensual gjinor i rëndësisë së faktorëve është një tjetër tregues i pjekurisë sociale të shoqërisë sonë, e cila tashmë ka filluar të ketë një vlerësim serioz të kërkesës imperative për barazi gjinore, midis të drejtës së burrave dhe grave për të qënë të barabartë në përzgjedhjen e tyre politike të pavarur, jashtë ndikimit determinues të ndryshimit gjinor. Këto vlerësime duhen nxitur akoma më shumë, për të larguar natyrën ende “seksiste” të politikës shqiptare, e cila ende me gjithë ndryshimet shfaqet e fortë në realitetin praktik. Por duke vlerësuar të dhënat e anketimit, duket se ka një ndryshim të dukshëm midis gjykimit të opinionit publik i cili në anketim shfaqet “pro” mbështetjes dhe favorizimit të pjesmarrjes së gruas në politikë dhe vendimmarrje, në forumet e larta të partive politike dhe në pushtetin ekzekutiv dhe nga ana tjetër ka një realitet tjetër, disi

ndryshe të realitetit vetë partive politike, të cilat kanë ende tregues të ulët të pjesmarrjes dhe përfaqësimit të grave, nëpër forumet e tyre kryesore, përkatëse politike.

Në këtë kontekst, partitë politike shqiptare duhet të shqetësohen për këtë realitet. Nuk është normale që gjykimi i drejtë i opinionit publik që kërkon dhe mbështet një pjesmarrje më të gjërë të grave në politikë, në vendimmarrje dhe përfaqësim në forumet e politikëbërjes, të jetë i diferencuar nga situata praktike dhe realitetet e sotme të përfaqësimit konkret të tyre nëpër forumet e të gjithë partive politike shqiptare, në të cilat ky nivel është ende i pakënaqshëm

II.B Fuqizimi ekonomik i gruas.

Natyrisht është normale që situata e barazisë gjinore të kuptohet dhe interpretohet e lidhur edhe me pozitën ekonomike të gruas në familje dhe vecanërisht në shoqëri. Studimi niset nga fakti i njohur dhe i pranuar apriori në studim, që roli i gruas në këtë aspekt është dukshëm inferior në krahasim me burrat.

Pozita e privilegjuar e meshkujve në punësim, në pagesë dhe drejtim është një tjetër shprehje e dukshme e faktit që në shoqërinë shqiptare, pabarazia gjinore shfaqet edhe në aspektin ekonomik. Natyrisht për të vlerësuar shkaqet e kësaj dukurie që marginalizon dhe disfavorizon femrat në raport me meshkujt, ka shumë arsye që lidhen me nivelin arsimor, aksesin e ulët ndaj burimeve financiare, ndaj informacionit të punës dhe atij ekonomik, mosmbështetje nga familja, mungesë të shërbimeve sociale që lehtësojnë barrën familjare të gruas, mentaliteti maskilist etj. Në tërësinë e vet, pesha e këtyre faktorëve ka qënë dhe vazhdon të jetë e ndryshme. Nga analiza studimore e anketimit rezulton si faktor kryesor që ndikon në këtë nivel të ulët të përfaqësimit të grave edhe si drejtuese biznesi.

Në të vërtetë duke analizuar faktorët e identifikuar si më të rëndësishëm për këtë pozitë të gruas në biznes, duket se faktorët e aksesit të tyre ndaj burimeve financiare dhe mungesa e kushteve mbështetëse sociale që favorizojnë pjesmarrjen konsiderohen si më kryesore. Duket se edhe burimet financiare që disbursohen, shkojnë dhe favorizojnë biznesin e burrave, duke i dhënë edhe këtij aktiviteti një akses të fortë maskilist. Në të vërtetë është jo vetëm një “realitet kombëtar” por është më saktë dukuri universale, në shoqërinë bashkëkohore. Biznesi konsiderohet të ketë një natyrë të spikatur maskiliste si veprimtari dhe “ekskluzivitet” burrash, për shkak të vështirësive dhe riskut që ai paraqet.

Ndërkaq, ky fakt është i lidhur me mentalitetin social i cili nuk e favorizon të drejtën e gruas për të qënë e barabartë me burrin në biznes. Pikërisht bashkimi i këtyre dy faktorëve që kanë të bëjnë me aksesin financiar të pabarabartë dhe mentalitetin se ‘biznesi nuk është punë grash, por veprimtari për burra’, ka sjellë këtë situatë. Në këtë linjë qëndron edhe fakti që të anketuarit mendojnë, se gruan në sfidën e saj për të qënë edhe faktor në biznes, nuk e favorizon as familja.

Pikërisht del përsëri në skenë një faktor madhor pengues për veprimtarinë publike të barabartë të femrës në shoqëri e cila lidhet me mentalitetet kufizuese që gjallojnë brenda familjes dhe që e pengojnë atë për të qënë aktive, e denjë, e barabartë me burrin në politikë, në vendimmarrje apo në biznes.

Në këtë kontekst duhet të thellohen studimet për të parë pengesat që i vijnë barazisë gjinore të gruas me burrin, nga “jashtë dhe nga brenda”, nga vetja dhe nga të tjerët. Sidomos kur është fjala për rolin ekonomik të saj është e nevojshme të diferencohen faktorët që bëhen pengesë dhe që vijnë nga mentaliteti që buron nga familja dhe atij që vjen nga shoqëria, si dhe peshën që ka secili faktor në këtë realitet social. Me shumë interes është fakti që edhe në vlerësimin e këtij komponenti të studimit, që ka të bëjë me rolin e gruas në biznes dhe faktorët që e pengojnë pjesmarrjen aktive të saj, ka një përgjigje adekuate dhe një rreshtim të barabartë të “faktorëve pengues” si nga përgjigjet

e meshkujve dhe të femrave. Kjo “barazi” në përgjigjet e tyre, është përsëri shumë pozitive, pasi tregon se edhe meshkujt, pozitën e tyre të privilegjuar si faktor sundues në biznes nuk e lidhin me “epërsi të vërteta apo të imagjinuara” me natyrë gjinore por me realitete të mentalitetit social i cili ndikon fuqishëm në pozitën e disfavorshme të gruas. Në këtë situatë konsiderohet si prioritare mbështetja e veçantë e shtetit për përmirësimin e situatës së grave në punësim dhe në biznes. Këtë veprim e quajnë të domosdoshëm rreth 94.8% e të anketuarve, të cilët në të njëjtën kohë janë të mendimit, se në këtë aksion gruaja duhet mbështetur duke përmirësuar treguesit e formimit profesional dhe njëherësh duke e mbështetur atë me kredi. Pavarësisht se nuk ka diskriminim në sistemet e kreditimit për shkaqe gjinore, ka probleme dhe pengesa që e mbajnë më larg gruan nga ky sistem favorizimi dhe nxitjeje. Në këtë kuptim, do të ishin favorizuese dhe nxitëse për gruan, masa që kanë të bëjnë me aplikimin e sistemeve të kreditimit me norma të zbutura, apo lehtësimi i sistemit të kreditimit për gratë si mjet që do t’i ndihmojë ato për të qënë më të pranishme në këtë fushë. Ndërkaq nga studimi del e dukshme nevoja që shteti të japë ndihmesë më aktive në drejtim të punësimit të grave, sidomos në sektorët publikë.

II.C Personaliteti i femrës dhe problemi i ngacmimit seksual në vendin e punës.

Fenomeni i ngacmimit seksual të femrës në punë dhe vendin e punës është një nga dukuritë shqetësuese, që cënon dinjitetin dhe personalitetin e saj. Nuk ka rëndësi se cila është shifra e atyre që e pohojnë këtë fakt. Rëndësi ka që ky fenomen ka filluar të jetë prezent në gjirin e shoqërisë tonë. Sipas anketimit rezulton se kjo dukuri është bërë shumë shqetësuese. Rezulton se 57.2% përqind e të anketuarve mendojnë se gratë ngacmohen seksualisht në vendin e punës nga pronari, eprori, etj. Ende më i rëndë është fakti që në shoqërinë tonë ende nuk është zhvilluar kultura e reagimit publik dhe e denoncimit të atyre që ngacmojnë dhe kërkojnë përfitim seksual për shkak të postit apo pronësisë. Kjo dukuri duhet vlerësuar me seriozitet maksimal pasi në një farë mënyre ky model i përfitimit seksual, është një nga format që nxit “prostitucionin zyrtar”, që krijon mentalitet se mund të sigurohet vendi i punës edhe duke bërë “lëshime” të tilla të papranueshme për shoqërinë moderne.

Fakti që vetëm 8.1% e të anketuarve mendojnë se ngacmimi seksual në punë denoncohet nga femrat, ndërsa 75.8% e tyre mendojnë se ky veprim nuk denoncohet, është alarmues. Ndër shkaqet e kësaj sate, të cilat janë shumë, si më prioritaret dhe ku duhet përqëndruar vëmëndja janë në radhë të parë, frika e grave se humbasin vendin e punës, mosbesimi në sistemin e drejtësisë dhe presioni i punëdhënësit. Ngritja e personalitetit të gruas, forcimi i dinjitetit personal dhe shpirtit reagues ndaj një veprimi të tillë që prek thelbin e shpirtit të saj si qenie njerëzore por dhe si përkatësi gjinore, denoncimi publik i “kodoshëve” kudo që ata janë dhe vendosja e tyre pa hezitim para ligjit, do të ishin kusht i domosdoshëm për të përmirësuar situatën dhe frenuar këtë dukuri të shëmtuar.

III. Të drejtat e gruas, legjislacioni, mekanizmi institucional.


Problemi i vlerësimit në praktikë të të drejtave dhe lirive që gratë gëzojnë në shoqëri, nuk është gjë e lehtë për t’u vlerësuar. Mekanizmat e vlerësimit të nivelit të plotësimit të këtyre të drejtave nuk janë të lehtë. Megjithatë nuk është vështirë të diktohet se me gjithë ndryshimet dhe përmirësimet evidente, në thelb shoqëria jonë vazhdon të jetë dukshëm maskiliste. Nuk është rastësi fakti që 76.8% e të anketuarve i përgjigjen në mënyrë mohuese pyetjes se “a i gëzojnë në praktikë gratë të drejtat e tyre në mënyrë të barabartë me burrat”.

Përmirësimi i situatës që ka të bëjë më liritë dhe të drejtat e barabarta të gruas në shoqëri është i lidhur me shumë faktorë politikë, ligjorë, moralë dhe institucionalë. Ndër

më kryesorët evidentohen, forcimi i shtetit ligjor që bën të mundur respektimin e të drejtës së barabartë të gruas dhe burrit para ligjit, ndërgjegjësimi dhe sensibilizimi i opinionit, fuqizimi i mekanizmave që ndikojnë në zbatimin dhe monitorimin e aplikimit social të të drejtave dhe lirive të barabarta, pavarësisht nga përkatësia gjinore.

Në këtë aspekt ka shumë ndikim fakti se sa njihen dokumentet dhe aktet politike dhe ligjore që janë garante të barazisë gjinore në shoqërinë tonë. Studimi evidenton disa fakte që duhen vlerësuar me seriozitet të veçantë. Ka një qëndrim të diferencuar në shkallën e njohjes së dokumenteve që garantojnë të drejtën e gruas. Opinioni publik njih më shumë dhe ka njohuri për dokumente të tilla themelore të përgjithshme sic është Kushtetuta dhe Kodi i Punës dhe ndërkaq ka njohuri më të kufizuara për Kodin e Familjes apo për Ligjin për Barazinë Gjinore.

Fjala vjen, është shqetësues fakti që Ligjin që specifikisht është për mbrojtjen e barazisë gjinore njihet vetëm nga 22% e të anketuarve, ndërsa 70.2% e tyre nuk kanë fare njohuri për të. Situata bëhet më shqetësuese kur bëhet fjalë për të njohur kushtet e legjislacionit ndërkombëtar që ka lidhje me “Barazinë gjinore” dhe detyrimet tona në nivel ndërkombëtar. Shumica e njerëzve me sa duket, kanë njohuri dhe njihen me përmbajtjen e Kartës së të Drejtave të Njeriut, derisa 95.4% e tyre shprehën se e njohin atë. Ndërkaq, kur vjen fjala për një dokument të tillë sic është Platforma për Veprim e Pekinit, njohuritë e njerëzve janë shumë të kufizuara, madje nuk është normale që për një dokument të tillë specifik e themelor, vetëm 6.8% e tyre kanë njohuri ose e njohin, ndërsa 93.2% e tyre nuk kanë asnjë njohuri për të.



Ndoshta duhet bërë më shumë punë për publikimin e akteve dhe dokumenteve me spektër dhe ndikim universal për të drejtat e grave në shoqërinë shqiptare, duke njohur kështu vlerën detyruese të tyre ndaj shoqërisë, shtetit dhe individit.

Studimi e evidenton si shumë urgjent këtë proces, pasi situata është e njëjtë edhe nivelin e ulët të njohjes së Konventës për “Eliminimin e të gjithë formave të diskriminimit të gruas” nga shoqëria jonë, si dhe të mekanizmit institucional që ndikon në realizimin e barazisë gjinore në shoqëri.

IV. Kujdesi social.

Studimi ka tentuar të realizojë lidhje të mundshme midis nevojës që ka shoqëria për të krijuar një barazi gjinore efektive duke e parë problemin të lidhur me elementët e shumtë

që kanë ndikim në këtë proces dhe që favorizojnë performancën e këtij treguesi në shoqërinë moderne, e cila e ka si një nga treguesit kryesor të saj “barazinë gjinore”. Ndiurma ndaj grave për të qënë të barabarta në shoqëri, është e lidhur me disa specifika gjinore të natyrshme dhe role stereotipike të konsoliduara padrejtësisht nga shoqëria si detyrime taksative të saj në familje.

Këto qëndrime stereotipike e mbajnë të lidhur dhe të vendosur gruan në disa “pozicione fikse”, që e pengojnë seriozisht atë që të jetë më e lirë, më aktive në jetën politike e sociale. Nuk është rastësi që nga studimi rezulton se pikërisht ky “predestinim” gjinor, që lidhet me rolin riprodhues të veçantë të femrës dhe lidhjet e saj të fuqishme me fëmijët, shpesh përdoret si “argument” për të justifikuar shkallën ende të ulët të pjesmarrjes së saj në jetën politike dhe publike. Madje sipas mendimit të shumicës absolute të të anketuarve (83.1%), ky faktor bëhet tepër frenues për to në tregun e punës.

Në numrin e shkaqeve që disfavorizojnë gruan në këtë aspekt, janë varfëria, mungesa e infrastrukturës sociale që zbut ngarkesat familjare të gruas dhe pengesat e saj që vijnë nga detyra dhe role stereotipike, që i janë ngarkuar tradicionalisht femrës (punët e shtëpisë dhe kujdesi për fëmijët).

Në këto faktorë shumë ndikues është konceptimi maskilist i rolit të mëmësisë si detyrim specifik gjinor i gruas dhe padyshim edhe koha e kufizuar që asaj i mbetet për jetën publike, politike, shoqërore e profesionale jashtë familjes.

Në këtë aspekt kanë ndikimin e vet negativ, jo vetëm sasia ende e vogël e shërbimeve sociale që ekzistojnë dhe që kanë efekt në zbutjen e barrës sociale të gruas, por dhe në fakti se për fat të keq, shumica nuk kanë njohuri as për ato institucione publike dhe private që realisht ekzistojnë dhe që mund të shfrytëzohen në favor të zbutjes së situatës tepër të ngarkuar të gruas në familje. Rrugët me të cilën gratë njihen me legjislacionin specifik social dhe impaktet e tij pozitive janë disa. Por duket se barrën kryesore të informimit me “benefitet sociale” dhe legjislacionin specifik, e kryejnë mjetet e informimit publik, kryesisht media elektronike dhe ajo e shkruar. Me shumë ndikim në këtë drejtim kanë qënë trajnimet e shumta që organizohen me gratë, shfrytëzimi i internetit etj.

Në mënyrë të veçantë nevoja për shërbime sociale të kualifikuara dhe alternative brenda dhe jashtë shtëpisë, kanë gratë e moshës së tretë, të cilat kalojnë një periudhë të vështirë moshore, shëndetsore dhe financiare. Nga studimi rezulton se shumica dërmuese e njerëzve mendojnë se është koha për të bërë përmirësime të dukshme në përmirësimin e situatës për njerëzit që kalojnë në moshën e pleqërisë së thellë, sidomos gratë. Të këtij mendimi janë 97.2% e të anketuarve, të cilët gjykojnë se shoqëria civile, shteti dhe OJF-të që janë të specializuara për shërbime sociale për këtë moshë, duhet të shtojnë shërbimet dhe kujdesin social, që favorizon përmirësimin e kushteve jetësore të tyre.

Nga analiza e kërkesave për politikë sociale më të mirë për moshat e treta evidentohen disa kërkesa prioritare që kanë të bëjnë me përmirësimin e kushteve ekonomike dhe sociale të të moshuarve. Ndër më kryesoret evidentohen, ato që kanë të bëjnë me situatën ekonomike të të moshuarit në familje. Ndaj në prioritetet e kërkesave të tyre evidentohen kërkesat për rritjen e pensioneve të pleqërisë, forcimin e “paketës” lehtësuese për kujdesin shëndetësor, etj. Por nuk janë të pavlerësuara kërkesat e të moshuarve të mbetur “të vetmuar”, “të braktisur”, “pa përkrahje”, të cilët kanë kërkesa të veçanta për shtimin e institucioneve alternative të përkujdesit social, në të gjithë format dhe tipologjitë, duke filluar nga shërbimi për të moshuarit në shtëpi, në komunitet, në qendra ditore argëtuese e shlodhëse, e deri tek qendrat e shërbimit komunitar.

Reforma sociale e ndërmarre kohët e fundit, shtrirja dhe zgjerimi i rrjetit të shërbimit komunitar, sidomos në Rajonet Pilot të Projektit të Bankës Botërore në Tiranë, Vlorë, Shkodër, Durrës, si dhe zgjerimi i rrjetit të shërbimit komunitar me Qendra Shërbimi për

të Moshuarit të drejtuara, menaxhuara dhe financuara nga organet e Pushtetit Vendor, kanë sjellë sinjale dhe klimë më pozitive për plotësimin e kërkesave dhe nevojave për shërbim social në komunitet. Ky impakt do të jetë më i fuqishëm në vitin 2007 që është dhe viti themelor i reformës që do të sjellë një realitet të ri të shërbimeve sociale, plotësisht të decentralizuara.

V. Kujdesi shëndetësor.

Ndër treguesit pozitivë të studimit, në krahasim me disa vite më parë, është fakti që njohuritë e grave për çështjet e shëndetit riprodhues dhe të planifikimit familjar janë në zgjerim të vazhdueshëm. Kjo është një garanci e madhe për shëndetin e tërësor të gruar si qenie dhe atë specifik si femër. Është shumë cilësor treguesi që tashmë nga 1196 të anketuar, femra dhe meshkuj, 73.5 % e tyre kanë njohuri dhe informacion të mjaftueshëm mbi planifikimin familjar dhe shëndetin riprodhues.

Megjithatë ka shumë rëndësi të vlerësohet burimi nga merret informacioni dhe njohuritë për shëndetin riprodhues dhe planifikimin familjar, pasi në këto tregues duket puna e diferencuar e familjes, shkollës, medias, partnerit etj. Studimi evidenton rolin e kufizuar, të ngurtë dhe disi të zbehur të institucioneve me funksione specifike edukative dhe informative, sic janë shkolla, institucionet mjekësore dhe vecanërisht roli i OJF-ve specifike të grave. Nëse do të shikojmë nga kjo pikpamje, të dhënat e studimit japin një tablo që duhet vlerësuar për të ardhmen:

Njohuritë nga gazetat dhe revistat 49.5 % e të anketuarve.

Nga televizioni dhe radioja	54.2 %
Nga veprimtaria e OJF-ve	18.8 %
Nga personeli shëndetësor	32.7%
Nga mësuesi dhe shkolla	14.9 %
Nga partneri	13.8 %

Me sa duket rolin kryesor në përhapjen e njohurive për shëndetin riprodhues dhe edukatën seksuale, e kanë mjetet e medias elektronike dhe të shtypit të cilat janë më shumë të përdorura jo vetëm si mjete argëtimi por dhe instrument për përhapjen e njohurive specifike që kanë të bëjnë me edukatën dhe higjienën seksuale dhe atë riprodhuese.

Janë shqetësuese shifrat që flasin për një ndikim të ulët të institucioneve të tilla specifike edukative, siç janë shkolla, institucionet mjekësore dhe vecanërisht OJF-të. Studimi nxjerr në dukje një shqetësim të veçantë i cili kohët e fundit është shumë i përfolur në opinionin publik. Ai ka të bëjë me efektivitetin shumë të ulët të Organizatave të shumta Joqeveritare, Jofitimprurëse efekti edukativ i të cilave në këtë fushë është ende shumë i ulët, gjë që flet për një veprimtari formaliste dhe me impakt të ulët në edukimin e grave me kulturën specifike gjinore dhe seksuale. Nuk është fjala për të vënë në dyshim rolin e jashtëzakonshëm të shoqërisë civile, por sidoqoftë duhen parë me seriozitet politik dhe financimet e shumta të OJF-ve që kanë efektivitet shumë të ulët në raport me “fondet sociale” që ato përdorojnë për qëllime sociale dhe edukative.

Në këtë kontekst duhet vlerësuar edhe niveli i ulët i njohurive dhe edukimit seksual që bëhet në shkolla, roli i të cilëve duhet të jetë dominant për krijimin e një kulture dhe edukimi seksual sa më të gjërë, duke ndikuar drejtpërdrejt mbi femrat dhe në mënyrë të tërthortë mbi meshkujt e rinj, për nevojën universale të një komponenti të tillë kulturor dhe jetik siç është kultura, edukata dhe standartet e higjienës specifike të kujdesit për jetën seksuale, e cila nuk ka vetëm funksione hedonistike, por ka vlerë sociale të veçantë për shëndetin riprodhues të femrës dhe rrjedhimisht edhe të brezave të rinj.

Me rëndësi janë edhe treguesit që kanë të bëjnë me faktin se kush vendos për numrin e fëmijëve që dëshiron të ketë çifti. Është tregues shumë pozitiv fakti që shoqëria jonë tashmë është në një stad të tillë zhvillimi social dhe emancipimi shoqëror, në të cilin shumicën absolute të zgjedhjes për këtë qëllim e bën çifti “me konsensus”.

Nga anketimi del se rreth 78.1 % e të anketuarve deklarohen se këtë vendim e marrin së bashku, burri dhe gruaja. Ndërkaq, ende ka shifra shqetësuese që flasin për një qëndrim të deformuar të vendimmarrjes për numrin e fëmijëve, sidomos në zonat rurale. Nuk është e ulët shifra që tregon se ende sot këtë të drejtë për të përcaktuar numrin e fëmijëve dhe kohën e lirë është e lidhur me të drejtën dhe “arbitraritetin seksual” të mashkullit, i cili e konsideron të drejtë të tij ekskluzive, sasinë dhe kohën e lindjes së fëmijës. Nuk është e vogël, e papërfillshme shifra e përgjigjes prej 14% e të anketuarve, sipas të cilëve, është burri ai që ende vendos për këto çështje të rëndësishme të jetës familjare, duke shpërfillur të drejtën e gruas në këtë aspekt të vendimmarrjes.

Ndërkaq, e drejta e gruas për të vendosur për numrin e fëmijëve dhe kohën e duhur të lindjes së tyre, është shumë e ulët në krahasim me të drejtën dhe ekskluzivitetin mashkullor. Vetëm 2.1 % e grave pretendojnë se e kanë këtë të drejtë.

Me shumë rëndësi për problemet e riprodhimit gjinor dhe shëndetin seksual të femrës, është jo vetëm edukata dhe edukimi seksual por dhe problemet e veçanta që kanë të bëjnë me realizimin e marrdhënieve seksuale të siguruara, duke realizuar shmangien e shtatzanive të padëshirueshme dhe sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, siç është HIV/AIDS, etj. Megjithëse nuk jemi të sigurt se për çfarë njohurish flasin të anketuarit dhe sa të sigurt janë këto njohuri, përsëri duket pozitiv fakti që informacioni për rrezikun e HIV/AIDS- it është bërë më i njohur në publikun e gjërë dhe që realisht ky rrezik, është kthyer në shqetësim social dhe shëndetsor dhe perceptohet si një nga rreziqet eminente të shoqërisë së sotme. Në kohën e tanishme kur po shfaqet fenomeni i liberalizimit të marrdhënieve seksuale dhe realizimi i tyre në disa raste kaotik dhe i pambrojtur, shoqëria shqiptare nuk është e imunizuar.

Në këto vite të fundit, ka një përhapje të gjërë të njohurive që kanë të bëjnë me “botën e seksit” duke e perceptuar atë jo vetëm si mjet riprodhimi dhe kënaqësie fizike dhe shpirtërore, por dhe si mjet që rrezikon jetën e çiftit, nëse ato janë marrdhënie rastësore, kaotike dhe veçanërisht të pambrojtura. Megjithë përmirësimet që kanë ndodhur, ende rreth 21.7 % e të anketuarve, deklarojnë se nuk kanë njohuri për sëmundjet seksualisht të transmetueshme e veçanërisht për rrezikun që paraqet HIV/AIDS për jetën e partnerëve seksualë. Kjo tregon se njohuritë që jepen për sëmundjet seksualisht të transmetueshme, janë ende të pamjaftueshme. Të këtij mendimi janë 75.2 % e të anketuarve.

Ky tregues është me të vërtetë shqetësues dhe familja, shkolla, institucionet e propagandës shëndetësore dhe veçanërisht organizatat e shumta jofitimprurëse të grave në vendin tonë duhet të mendohen më mirë dhe të punojnë më shumë në drejtim të zgjerimit të njohurive që kanë të bëjnë me kulturën dhe edukatën seksuale. Studimi evidenton si fakt se njohuritë më të gjera dhe më të qëndrueshme për probleme të kulturës, edukatës dhe rreziqeve që vijnë nga marrdhëniet seksuale kaotike dhe të pambrojtura njerëzit i marrin në radhë të parë, nga tri burime kryesore që janë shkolla, televizioni dhe familja dhe më pak nga gazetatat, OJF-të, apo akoma më keq nga personeli mjekësor.

Shumë shqetësues është në këtë drejtim edhe mentaliteti që ende vazhdon të jetë i fuqishëm sidomos tek meshkujt, të cilët shpesh nuk e kanë perceptimin e drejtë dhe të saktë të rreziqeve që sjell seksi i pambrojtur. Ka një paradigmë të vjetër tek meshkujt shqiptarë, të cilët e kanë bezdi përdorimin e kondomit si mjet për të parandaluar shtatzaninë e padëshirueshme, apo marrjen e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, sidomos kur bëhet fjalë për marrdhënie seksuale me partner të

rastësishëm, të cilët në shumicën e rasteve janë shkak kryesor që ndikon në përhapjen e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme.

Megjithatë, ka një ndryshim në këtë aspekt. Rezultati i anketimit të fundit tregon se 47.6 % e të anketuarve mendojnë se përdorimi i kondomit si mjet për shmangien e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, është efektiv dhe i domosdoshëm. Por nuk është normale që në kushtet e shoqërisë moderne dhe të një klime të liberalizuar, të "lirisë seksuale", të ketë rreth 25.9 % të të anketuarve që të deklarohen se nuk kanë njohuri për vlerën mbrojtëse në përdorimin e kondomit për të patur marrdhënie seksualisht të mbrojtura. Akoma më keq, që rreth 3.8 % e tyre nuk kanë fare njohuri për ekzistencën e këtij mjeti për mbrojtjen e shëndetit integral dhe atij riprodhues vecanërisht.

Është me rëndësi fakti që shoqëria shqiptare, ka tashmë një nivel të lartë perceptimi për dhunën jo vetëm si mjet primitiv i "epërsisë gjinore" por dhe si çështje që ka të bëjë me shëndetin publik. Me fjalë të tjera, tashmë është pozitiv fakti që perceptimi i dhunës ndaj gruas nuk është më çështje e jetës private të çiftit, por dhe çështje e madhe publike e cila ka të bëjë jo vetëm me shëndetin personal fizik dhe mental të femrës së veçantë, por është edhe çështje e madhe publike dhe tregues i shëndetit social të shoqërisë shqiptare në përgjithësi. Këtë perceptim social të dhunës e kanë 67.6 % e të anketuarve, ndërsa 30.5 % e tyre mendojnë ndryshe dhe kanë koncept ende të kufizuar për impaktin social që ka dhuna në shoqërinë moderne, si mjet deformativ i marrëdhënieve midis meshkujve dhe femrave në të gjithë ambientet ku ata jetojnë, bashkëjetojnë apo realizojnë marrëdhëniet e tyre të natyrshme bipolare.

VI. Arsimi dhe eliminimi i dallimeve gjinore.

Pa dashur të biem në pozitat e iluminizmit dhe duke mos e konsideruar arsimimin dhe nivelin kulturor të shoqërisë si të vetmin kusht dhe mjet për të realizuar barazinë gjinore në shoqëri, duhet të pranojmë megjithatë se ndikimi i arsimit dhe i kulturës në këtë proces, është shumë i rëndësishëm dhe vendimtar. Pa e hipertrofizuar rolin e arsimit, duhet pohuar se megjithatë ai mbetet një nga mjetet e rëndësishme, që ka në dorë shoqëria moderne si instrument ndërgjegjësimit për të gjithë shoqërinë, për rëndësinë që ka një shoqëri e cila krijon barazi gjinore të vërtetë, duke shmangur dallimin, diskriminimin dhe abuzimin gjinor, duke respektuar të drejtën e femrës për të patur shanse të barabarta me burrin në çdo aspekt të jetës.

Në këtë kontekst, përveç ndikimeve dhe impakteve të tjera pozitive që ka arsimi në shoqërinë moderne, ndikimi i tij është i fuqishëm edhe për betejën e shoqërisë tonë për kulturimin e njerëzve si mjet për të afruar barazinë gjinore dhe shikimin human, të padiferencuar për shkak të gjinisë apo identitetit seksual të ndryshëm të gruas.

Në këtë kontekst duket një interesim i veçantë për këtë rol me të cilin "indirekt" arsimi, po ndikon në krijimin e një shoqërie civile, të barabartë nga pikpamja gjinore, të hapur për të gjithë, duke i konsideruar si njerëz me të drejta të barabarta dhe pa asnjë diskriminim gjinor. Studimi evidenton disa nevoja dhe prirje të zhvillimit të arsimit, duke i parë ato jo si çështje që kanë të bëjnë dhe që shfaqen thjesht me natyrë pedagogjike, por si një faktor ndihmës dhe instrument social që ndikon në përmirësimin e situatës së barazisë gjinore në shoqërinë tonë. Në studim, evidentohen si kërkesa prioritare nevoja për më shumë buxhet nga shteti për zhvillimin sasior dhe cilësor të arsimit, pasi sa më shumë njerëz të pashkolluar të kemi, sidomos në fshatrat dhe zonat e thella rurale, aq më shumë probleme do të kemi për sigurimin e drejtësisë, barazisë gjinore midis burrit dhe gruas. Në kohën tonë janë shumë të rëndësishme, jo vetëm veprimet financuese dhe menaxhuese të shtetit, por dhe veprimi më energjik i shoqërisë civile për të rritur shkallën e ndërgjegjësimit dhe të sensibilizimit për rolin që ka arsimi si mjet që ndikon në zbutjen e "klimës mashkullore" dhe humanizimin e marrëdhënieve midis burrave dhe

grave në shoqëri. Në shoqërinë tonë duket se ka një pretendim më evident, për një cilësi më të lartë në mësimdhënie. Në të njëjtën logjikë dhe me të njëjtën 'gjatësi vale', ka një kërkesë me natyrë imponuese nga shoqëria, e cila kërkon që niveli i arsimit të njerëzve tanë, të mos cedojë për shkak të moszbatimit të ligjit për arsimin e detyrueshëm dhe shmangien e treguesve të braktisjes së shkollës.

Duke qënë se për shkak të riorganizimit të jetës shoqërore mbi principet e lirisë personale dhe ekonomisë së tregut, fenomeni i braktisjes së shkollës, i uljes së cilësisë së arsimit ndihet sidomos në fshat, veçanërisht në zonat e thella malore. Pikërisht kjo situatë e vështirë e arsimit në zonat e thella rurale i cili tashmë është një fenomen i identifikuar për të cilin Qeveria ka plane dhe programe të vecanta ndërhyrjeje, e ka detyruar shumicën absolute të të anketuarve, të shprehën pothuaj njëzëri se është shumë e rëndësishme marrja e masave mbështetëse dhe lehtësuese për frekuentimin e shkollës nga fëmijë që vijnë nga familje të varfëra (zona urbane dhe veçanërisht rurale). Ndër masat që propozohen për të ndryshuar situatën e frekuentimit dhe ndjekjes së vazhduar të shkollës nga nxënësit në shkollat sidomos në zonat rurale, janë përballimi i disa shpenzimeve shtesë për të ndihmuar familjet e varfëra, duke i dhënë nxënësve një sasi të nevojshme ushqim falas, përballimi nga buxheti i shtetit dhe buxhetet e pushteteve lokale, të një sasi të logjikshme shpenzimesh duke ju dhënë nxënësve tekste falas.

Me rëndësi për përmirësimin e treguesve të arsimit dhe të vijimit të shkollës nga fëmijët e zonave rurale është dhe mbështetja e veçantë psiko-sociale e fëmijëve dhe e familjeve të tyre, për të krijuar një koncept të qartë për nevojën e shkollimit të fëmijëve si një investim familjar, personal dhe social, që është i rëndësishëm dhe që më pas i kthehet në mënyrë të shumëfishtë familjes, individit dhe shoqërisë. Në këtë kontekst, investimi për arsimimin e brezit të ri edhe në këndshikimin e barazisë gjinore, nuk është investim i humbur.

Natyrisht shkolla është institucioni më specifik jo vetëm që kulturon por hedh bazat e kulturës gjinore dhe të perceptimit të barabartë të djemve dhe vajzave si qenie të barabarta, me të drejta të njëjta por vetëm të ndryshëm nga pikpamja gjinore dhe identiteti seksual. Në shkollë hidhen bazat e kulturës së një shoqërie të drejtë, të barabartë nga pikpamja gjinore, të hapur, në të cilën kultivohet qëndrimi i padiferencuar midis djemve dhe vajzave për shkak të ndryshimit të identitetit gjinor dhe përkatësisë seksuale të ndryshme.

Kjo kulturë e barazisë gjinore, e krijuar që në bankat e shkollës bëhet një fundament social i cili e ndihmon njeriun që edhe në jetë të ketë një perceptim të drejtë për këtë barazi. Megjithatë edhe shkolla është produkt social i shoqërisë dhe zhvillohet në terrenin tonë, i cili ende ka nuanca të forta të maskilizmit, të cilat shpesh ndihen edhe në ambientet e shkollës, në programe, tekste dhe metodat e mësimdhënies, në të cilat jo rrallë bëhet diferencim midis nxënësve për shkak të identitetit të veçantë seksual dhe të tipologjisë së vjetër ndarëse, në detyra dhe përgjegjësi për djem apo për vajza. Fakti që jo pak por rreth 36.7 % e të anketuarve, e pranojnë se arsimi në Shqipëri ende "prodhon" pabarazi midis vajzave dhe djemve, është shqetësues dhe duhet vlerësuar seriozisht në punën e shkollës sonë.

Në përmbajtjen e punës së shkollës ashtu si dhe në tekstet mësimore, shpesh infiltrojnë mendime, koncepte dhe ide që mbajnë të gjallë dhe kultivojnë në shkollë koncepte ambiguidë ose të gabuara për probleme të shikimit dhe trajtimit të barabartë të djemve dhe vajzave, duke shmangur çdo mentalitet që prodhon pabarazi konceptuale dhe sociale.

Pikërisht për shkak se edhe shkolla nuk është një institucion i "purifikuar" nga qëndrimet që "prodhojnë" koncepte dhe praktika të diferencuara dhe pabarazi gjinore, del e nevojshme që të rishikohen me prioritet nga ky këndshikim programet, tekstet, kurikulat

dhe metodat e mësimdhënies, duke shmangur nga to çdo interpretim maskilist, diferencues që kultivon sjellje dhe kulturë që mban gjallë pabarazinë gjinore.

Nga studimi rezulton si detyrë prioritare dhe imperativ, në radhë të parë trajnimi i stafit mësimdhënës në lidhje me krijimin e koncepteve dhe perceptimeve të drejta qytetare për barazisë gjinore duke filluar nga vetë mësuesit dhe edukatorët, njohuritë e të cilëve transmetohen përmes mësimdhënies edhe tek nxënësit e tyre. Natyrisht edukimi i ndjenjës së barazisë gjinore, kërkon elaborimin e koncepteve edhe përmes programeve, teksteve dhe lëndëve të veçanta që krijojnë një sfond të gjerë kulturor, në mënyrë që të rinjtë të kenë njohuri të mjaftueshme dhe të drejta për rolin dhe rëndësinë e barazisë gjinore, si tipar i një shoqërie të drejtë dhe të barabartë. Në këtë perceptim social, është detyrë që të bëhet gradualisht rishikimi i teksteve me këtë frymë të barazisë gjinore, të shmangen me çdo kusht konceptet maskiliste, ndikimi negativ i të cilëve në kulturën e nxënësve është ende i dukshëm.

Pa këtë ambient kulturor që të nxisë barazi gjinore është e pamundur të perceptohet ndryshimi radikal që pritet të ndodhë në këtë fushë.

VII. Gruaja dhe media.

Pa dyshim nga studimi duket se media ka një rol jashtëzakonisht të madh në kultivimin e koncepteve të drejta dhe të ekuilibruara për çështjet e barazisë gjinore. Nuk është rastësi që në të gjithë çështjet e analizuara dhe të diskutuara në këtë studim lidhur me problematikën e barazisë gjinore, roli i medias është shumë i rëndësishëm.

Forca, fuqia dhe ndikimi elokuent i medias është i pranuar nga të gjithë si mjet që ka mundësi të gjëra të ndikimit kulturor dhe për përpunimin e opinionit publik, për të krijuar koncepte të drejta sociale. Natyrisht roli i medias është parë në dy këndshikime, konceptual, dmth si mjet që ndikon drejtpërdrejt në kultivimin e kulturës që sjell barazi gjinore, koncepte të drejta për rolin e veçantë shoqëror të gruas si qenie sociale e barabartë dhe pa asnjë dallim nga burrat, duke publikuar ide të drejta e të shumanshme për këtë çështje.

Nga ana tjetër, media ka një rol të pazëvendësueshëm edhe nga pikpamja kontekstuale, si mjet që publikon të drejtat e saj humane dhe shkeljet që ndeshen në shoqërinë tonë. Për të konceptuar rolin e veçantë të medias sidomos në aspektin e fundit, kontekstual, në realitetin tonë, mjafton të interpretojmë drejt të dhënat e anketës së realizuar. Natyrisht media nuk është instrument i drejtpërdrejtë me “detyrë specifike” për të qënë interprete vetëm për çështjet gjinore. Megjithatë shpesh në interpretimet mediatike të problematikës gjinore, ka qëndrime të shpërpjestuara të interpretimit të interesave dhe shqetësimeve që kanë gratë nga qëndrimet diskriminuese, diferencuese dhe dalluese që shfaqen në shoqërinë shqiptare. Kështu media merret ende shumë pak me shqetësimet dhe pozitën ekonomike të gruas si dhe raportin e saj të diskriminuar në raport me “tregun e punës”.

Të këtij mendimi janë shumica e të anketuarve, ose 61.6 % e tyre, të cilët kërkojnë që me këtë problem themelor që është shfaqje e dukshme e pabarazisë gjinore të gruas me “botën e punës”, media duhet të ngrejë zërin më shumë dhe të thotë fjalën e saj me autoritet të plotë.

Media ka një rol të veçantë në përfshirjen e gruas në jetën politike, në të cilën treguesit e maskilizmit janë qartë të dukshëm. Nuk ka mjet më të fuqishëm sensibilizues dhe instrument më të saktë për të evidentuar të vërtetën dhe demagogjinë e shfaqur nga të gjithë partitë politike në Shqipëri në të cilat prezenca e faktorit femër, sidomos në strukturat drejtuese të tyre është ende e ulët dhe shqetësuese. Megjithatë, sipas studimit edhe këtë rol media nuk e realizon në parametrat e kërkuara të shoqërisë civile dhe qytetërimit modern. Vetëm 24.5 % e të anketuarve, janë të kënaqur me interpretimin

mediatik të problemit të pjesmarrjes së gruas në politikë, ndërsa shumica absolute e tyre ose 75.5 % e të anketuarve, i përgjigjen negativisht rolit që media aktualisht po luan në zgjerimin dhe nxitjen e procesit të rritjes së treguesve të pjesmarrjes së gruas në politikë dhe vendimmarrje aktive. Akoma më i “padukshëm” shfaqet roli i medias në shqetësimet dhe problemet e arsimimit të femrës në përgjithësi dhe të gruas në veçanërisht. Edhe këtu shifrat flasin për një punë jo të përqëndruar të medias për shqetësimet arsimore të grave në shoqërinë tonë.

Vetëm 18.1 % e të anketuarve janë të kënaqur me interferimet mediatike në shqetësimet arsimore specifike të grave dhe nga ana tjetër rreth 81.9 % nuk janë të kënaqur nga roli i medias në këtë fushë. Duket se për problemet dhe shqetësimet që kanë gratë në çështjet ekonomike, në angazhimin politik dhe shqetësimet arsimore, roli i medias nuk është në nivelin që kërkohet dhe në përputhje me standartet e interpretimit të natyrshëm të “çështjeve gjinore”. Situata paraqitet më mirë në rolin e medias, kur është fjala për publikimin, interpretimin dhe mbrojtjen e të drejtave të grave në fushën e të drejtave të tyre qytetare dhe në përballimin e problemeve sociale me të cilat ato ndeshen në jetë.

Pikërisht këto rezultate të perceptimit publik të rolit të medias, kanë krijuar idenë se edhe vetë media nuk i ka njohuritë e plota, të sakta, të qarta dhe sipas standarteve ligjore të shoqërisë moderne, për barazinë gjinore dhe të drejtat e patjetërsueshme të grave në shoqëri. Si rezultat, vetëm gjysma e të anketuarve ose më saktë rreth 54.8 % e tyre, janë të mendimit ose besojnë se vetë media ka njohuri, koncepte sociale dhe ligjore të qarta për të drejtat gjinore të gruas.

Në të njëjtën kohë që rreth 45.2 % e tyre janë të mendimit se media ose nuk është e njohur me standartet e barazisë gjinore, ose në organet e tyre shpesh procedohet me njohuri gjysmake, jo të plota dhe interpretime intuitivo populiste, duke qenë larg standarteve të miratuara nëpërmjet ligjeve kombëtare dhe në Konventa Ndërkombëtare të ratifikuara nga Qeveria, Parlamenti, etj. Kjo situatë e bën të domosdoshme nevojën e një procesi të përsheptuar të edukimit të gazetarëve, paisjen e tyre me njohuri të gjera të sakta sociologjike, psikologjike dhe ligjore për të qënë interpretë të saktë dhe të qartë të problematikave me natyrë politike, ekonomike, sociale, arsimore, shëndetsore dhe qytetare që kanë të bëjnë me garantimin e të drejtës së gruas për barazi ligjore detyruese dhe jo voluntariste.

Pa këtë tipologji mediash dhe gazetarësh, nuk është i mundur realizimi i misionit të tyre specifik. Ndoshta në trajnimet kualifikimet dhe shkollimet specifike pasuniversitare dhe master, do të duhej të ishte e pranishme edhe një sasi më e gjërë e gazetarëve socialë, të cilët duhet të njohin më në themel dhe radikalisht problematikën specifike, kuadrin ligjor dhe interpretimet sociale moderne të shoqërisë bashkëkohore për të drejtat e grave për të qënë të barabarta në një shoqëri të drejtë.

Studimi ka evidentuar në mënyrë të përgjithësuar problemet që qëndrojnë midis medias dhe gruas, si dhe për nevojën e “përmirësimit të detyruar” të relacioneve bashkëpunuese midis tyre. Duket se gjëja e parë që duhet për të përmirësuar këtë relacion, është ndërgjegjësimi i drejtuesve dhe gazetarëve të medias elektronike dhe të shkruar për rëndësinë e problemit të barazisë gjinore, jo si problem iluminist dhe social, por si një nga problemet dhe sfidat e mëdha të politikës bashkëkohore të qytetërimit modern. Në këtë kontekst studimi eidenton si shumë të rëndësishme edhe vetë luftën e grave për të bindur dhe ndërgjegjësuar më shumë veten për të drejtën e saj të patjetërsueshme dhe të pamohueshme nga askush, për të qënë e barabartë në të gjithë aspektet me burrin, duke shmangur të gjithë qëndrimet pasive, mazokiste, që krijojnë mentalitetin tradicional të inferioritetit të saj në raport me burrat.

Në studim eidentohet nevoja për më shumë ambicje të grave për të qënë kompetitive në çdo fushë me burrat, të afta për të shfaqur me krenari dhe pa hezitim dijet, njohuritë

dhe aftësitë e tyre, jo vetëm në jetën profesionale por dhe në ambientet e politikës profesionale dhe mediatike.

KAPITULLI III

REKOMANDIME

Përcaktimi i konkluzioneve dhe rekomandimeve që duhet të jenë si prioritare për etapën e re të luftës së gruas dhe shoqërisë shqiptare për thellimin e treguesve të barazisë gjinore, duke e kthyer atë në një sfidë sociale, synon që të ravijëzojë disa detyra, objektiva dhe tregues të matshëm për punën e të gjithë institucioneve shtetërore, publike, të medias dhe shoqërisë civile. Pa tentuar për të kornizuar objektivat dhe rekomandimet jashtë mundësive dhe realitetit, jemi mbështetur në objektivat e përgjithshëm të politikave shtetërore për shanse dhe mundësi të barabarta dhe barazinë gjinore si tregues sintetik i shoqërisë moderne, në kuadrin ligjor që përcakton juridikisht liritë dhe të drejtat e njeriut dhe veçanërisht të gruas, në objektivat specifike gjinore që gjenden të shkruara në objektivat politikë, socialë, ekonomikë, ligjorë e arsimorë të shtetit dhe shoqërisë. Në këtë detyrë një ndihmë të posaçme ofron dokumenti i “Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, 2007-2010” i Ministrisë së Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, si dhe në konkluzionet e studimit të realizuar përmes një anketimi të gjërë për këtë problem.

Natyrisht çështja e barazisë gjinore duhet parë duke i bërë disa analiza dhe prerje të gjithanshme këtij problemi, i cili është vërtet një problem politiko-social dhe gjinor më shumë pamje dhe prerje të lidhura me gruan si qenie sociale të barabartë. Por problemi duke qënë “prizmatik” është i vështirë për t’u gjykuar në të gjithë pamjet e mundshme në kuadrin e një studimi të realizuar mbi bazë të një anketimi, i cili sado i plotë që të jetë nuk është i mjaftueshëm për të dhënë gjykime të plota.

Kjo do të thotë se problemi duhet parë si çështje politike, që lidhet me të drejtat politike të gruas në vendimmarrje, si problem social që ka të bëjë me të drejtat e gruas si njeri, dhe me problemet me të cilat shfaqet ky problem në ambientin familjar. Një shikim i tillë kompleks i treguesve mund të ndihmojë që të mbërrijmë në një pikë të përafërt të realitetit social dhe të nxjerrim konkluzionet e duhura.

1. Realizimi në vazhdimësi i studimeve më të plota, sistematike dhe të gjithanshme për njohjen më të thelluar të problematikës, të thellësisë, intensitetit të diferencuar të shfaqjes së problemeve të barazisë gjinore në vendin tonë.

Drejtoria e Mundësive dhe Shanseve të Barabarta, por dhe institucione të tjera të shtetit dhe të shoqërisë civile duhet të angazhohen me kontribute profesionale studimore për të intervenuar në këtë çështje me rëndësi politike dhe sociale. Angazhimi në veprimtari studimore, riorientimi i tematikave me natyrë gjinore në studimet e kryera në nivel universitar dhe master, sidomos nga studiues dhe profesorë të Fakultetit të Shkencave Sociale, do të ishte një kontribut i veçantë dhe shumë i rëndësishëm. Në këtë kontekst do të ishte i dobishëm një bashkëpunim institucional i Drejtorisë së Shanseve të Barabarta, në Ministrinë e Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta me Fakultetin e Shkencave Sociale dhe OJF-të që kanë në fokusin e tyre trajtimin e çështjeve gjinore.

2. Domosdoshmëria dhe rëndësia e mbledhjes së të dhënave statistikore gjinore për realizimin e analizave studimore, për njohjen në thellësi të situatës aktuale nga këndvështrimi gjinor, për hartimin dhe implementimin e programeve konkrete dhe efektive, duke synuar arritjen e barazisë gjinore.

Realizimi i studimeve të thelluara dhe vlerësimi i nevojave për ndërhyrje të organizuar shtetërore, ligjore, sociale, arsimore e shëndetësore për përmirësimin e treguesve të saj, nuk mund të realizohen pa patur të dhëna të plota, të sakta e sistematike mbi evolucionin e procesit gjinor dhe treguesit e performancës dhe progresit të barazisë gjinore. Duhet bërë më shumë punë e institucionalizuar nga të gjithë institucionet (MPCSSHB dhe INSTAT) në drejtim të përfshirjes së të dhënave gjinore në statistikat pasi ato momentalisht janë të pamjaftueshme. Kështu, mungojnë një seri treguesish për matjen e politikave dhe programeve pro-gjinore. Mungesa më e madhe identifikohet në treguesit e buxhetimit apo në tregues të tjerë që masin jetën dhe punën e gruas në fshat. Nëse jepet numri i femrave të punësuara ose të papuna nuk kemi të dhëna më specifike në fushën e punësimit si psh. numri i femrave të punësuara në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, në mënyrë që të monitorohen treguesit e ndjeshmërisë gjinore të cilat shërbejnë si bazë për hartimin e politikave dhe programeve në të gjitha nivelet e qeverisjes vendore dhe qendore.

3. Hartimi i strategjive dhe politikave me natyrë “pro-gjinore” me objektiva të qarta dhe të realizueshme në fushën arsimore.

Këto politika duhet të synojnë sigurimin e një arsimimi jodiskriminues për vajzat dhe djemtë duke hedhur themelet e konceptit të barazisë gjinore nëpërmjet hartimit të teksteve dhe programeve shkollore të analizuara nga këndvështrimi gjinor, në rritjen e frekuentimit të shkollës nga vajzat dhe djemtë në të gjitha nivelet arsimore dhe në të gjithë territorin e vendit, në zgjerimin e rrjetit të institucioneve arsimore dhe në përmirësimin cilësor të tyre, në rritjen e nivelit të mësimdhënies etj. Të gjitha këto reforma dhe programe kërkojnë anagazhimin dhe bashkëpunimin e ngushtë të të gjithë grupeve të interesit dhe veçanërisht në bashkëpunim me trupën mesimdhënëse, prindërit, OJF-të etj.

4. Forcimi i rolit edukativ dhe publicistik të medias së shkruar dhe elektronike, e cila përmes një veprimi të kompaktësuar mund të bëhet aleate e fuqishme e gruas shqiptare në betejën e saj për barazi e drejtësi sociale në luftë me të gjithë pengesat dhe paragjykimet me të cilat ajo ndeshet.

Rikonceptimi i problemit në një spektër më të gjërë ndikues politiko-social të medias, duke ju shmangur karakterit sensansional dhe deskriptiv të mediatizimeve për bujë, dhe riorientimit të saj në thelbin e problemit të barazisë gjinore si një problem që nuk është thjesht dhe vetëm specifik, por në radhë të parë politik dhe shoqëror. Në media duhet të zvogëlohet shikimi i tematikës dhe shkeljeve të të drejtave të grave thjesht si “skup” për të intriguar pasivisht opinionin publik me fakte dhe ngjarje ordinere të jetës së përditëshme, apo thjesht me “numërimin e rasteve” të dhunimeve dhe përdhunimeve me natyrë gjinore. Tani ka ardhur momenti që në shoqërinë tonë e cila ka tregues të shfaqur të modernitetit, media të jetë më luftarake në mbështetjen e politikave aktive të shtetit, shoqërisë civile dhe vetë grave për të realizuar objektivin e tyre strategjik gjinor.

5. Njohje e kuadrit ligjor vendas dhe atij ndërkombëtar për gruan dhe barazinë gjinore si dhe përmirësimi legjislativ ekzistues dhe ndërmarrja e inisiativave të reja ligjore në këtë fushë.

Në këtë kontekst, nga analiza e situatës aktuale në këtë fushë janë të domosdoshme të përqëndrohet puna më prioritet në dy drejtime kryesore. E para është njohja e legjislativit ekzistues dhe i mbrojtjes ligjore që ato krijojnë për garantimin e lirive dhe të drejtave të barabarta të gruas në politikë, ekonomi, arsim, shëndetsi, në jetën publike dhe private, duke rritur në një shkallë të re “ndërgjegjen juridike” dhe aftësitë vetperceptuese të të drejtave të saj. E dyta, në stadin e ri të zgjerimit të hapësirës së barazisë gjinore është e domosdoshme që hap pas hapi të ndërmerren inisiativa të reja ligjore si dhe përpjekje për të rregulluar e përmirësuar legjislativin ekzistues duke tentuar për ta sjellë atë gradualisht, konform me standartet më të mira të Bashkimit Europian të barazisë gjinore.

6. Angazhimi i veçantë i shoqërisë civile në këtë proces është mision ‘i detyruar’ i saj, i natyrshëm dhe i detyrueshëm për t’u plotësuar.

Pa mohuar atë që kanë bërë shoqatat e grave në Shqipëri, pa zvogëluar luftën dhe arritjet e tyre në sensibilizimin e shoqërisë, politikës, shtetit dhe vetë grave, duhet përqëndrim me më shumë “nerv social” për të kaluar në një etapë të re cilësore të ndërgjegjësimit të tyre për kërkesat dhe imperativat e rij politike dhe sociale që qëndrojnë para tyre. Shoqëria civile duhet të ndryshojë aksin e punës së vet, pasi situata në të gjithë problematikën e çështjeve gjinore nuk është më ajo që ka qënë në fillim të proceseve demokratike. Situata e re, problemet që shqetësojnë realisht problemet gjinore nuk mund më të zgjidhen me veprimtaritë “lineare” të disa OJF-ve të cilat vazhdojnë përsëri të ecin në të njëjtën rrugë, me të njëjtin temp duke mbetur në periferi të interesimeve të vërteta të gruas. Shoqatat e grave duhet të gjejnë më mirë pozicionin e tyre si instrumente të ndërmjetësimit midis shtetit dhe grave si “grup interesi”. Ato duhet të bëhen më mirë avokate dhe interlokutore të mbrojtjes së interesave të tyre për barazi dhe “luftëtare” për të ngritur zërin dhe mbrojtur gratë nga çdo padrejtësi që mund t’u bëhet atyre nga kushdoqoftë.

